

ATEIZMI

Një vështrim kritik

Dr. Salih ibn Abdulaziz ibn Uthman Sindij

*Profesor i lëndës së besimit
në Universitetin Islamik të Medines*

ATEIZMI, një vështrim kritik

Titulli i librit në origjinal:

الإلحاد، وسائله، و خطره و سبل مواجهته

Autor: Dr. Salih ibn Abdulaziz ibn Uthman Sindij

Përkthyen:

Ervis Bilali

Edmond Ajdini

Redaktor fetar:

Shuajb Rexha

Redaktor gjuhësor:

Entela Hidri

Kopertina dhe faqosja:

Pelegrini



© Të gjitha të drejtat janë të ruajtura nga
Qendra Kulturore Fetare Udha e Besimtarëve
Tiranë, janar 2015.
www.udhaebesimtareve.com

BRENDIA

Parathënie e autorit

7

Çfarë është ateizmi?

13

Të gjitha këto studime flasin për jomyslimanët,
por si është gjendja në botën islame?

16

Rrymat ateiste

18

Kapitulli i parë

Shkaqet që çojnë drejt ateizmit

21

Ideologjia mbi të cilën është ngritur mendimi ateist
dhe në çfarë i thërret njerëzit

24

Baza e parë: teoritë shkencore eksperimentale

25

Kapitulli i dytë

Teoritë filozofike

35

E para: Mbivlerësimi i mendjes

35

E dyta: Parimi i dyshimit

41

E treta: Botëkuptimi i ngushtë dhe i gabuar që
ateistët kanë rreth çështjeve të Kaderit
(vendimit dhe paracaktimit hyjnor)

47

E katërta: Disa pretendime absurde dhe të
papranueshme logjiksht, tek të cilat bazohen ateistët

50

Kapitulli i tretë

Mënyrat se si promovohet ateizmi

57

Kapitulli i katërt

Mënyrat dhe mjetet e ballafaqimit
me ideologjinë ateiste

65

Mbyllje

79

PARATHËNIA E BOTUESIT

Falënderimi dhe lëvdata i takon Allahut, Sunduesit të Gjithëdijshtëm. Lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi më të mirin e krijesave Muhamedin – alejhis-salatu ues- selam, mbi familjen dhe shokët e tij fisnikë. E më pas:

Kjo është një broshurë origjina e së cilës ishte një leksion që e mbajti shejkhu ynë i nderuar, dr. Salih ibn Abdulaziz Sindi, në Universitetin Islamik (të Medines) më datë: 12/03/2012.

Unë isha prezent në atë leksion dhe kisha dëshirë prej asaj kohe që ta botoja, por më pengoi diçka. E ja tani mu dha rasti dhe iu përkushtova botimit të saj, duke e krahasuar tekstin me origjinalin e saj në audio. Përmenda ajetet kuranore me referencat e sureve përkatëse, cilësova librat nga ku janë marrë hadithet e përmendura në të dhe përmirësova shprehjet që kishin nevojë për përmirësim për shkak të trajtës së ligjërit, në mënyrë që t'i përshtaten gjuhës së shkruar. Pastaj ja parashtrova autorit - Allahu i dhëntë sukses - dhe ai e rishikoi edhe një herë librin.

Allahut i kërkojmë që nijetet (qëllimet) tona t'i bëjë të mira dhe punët tona të sakta, që ta rezervojë këtë vepër tek Ai, ta falë shejkhun tonë (dr. Salih Sindin) dhe ta lartësojë pozitën e tij. Lavdërimi, paqja e begatia e Allahut qofshin mbi Profetin tonë Muhamed, mbi familjen dhe shokët e tij!

Shkroi: Rabia ibn Ahmed El Bejtari

PARATHËNIE E AUTORIT

Falënderimet dhe lëvdatat i takojnë Allahut i Cili e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë që ta bëjë atë mbizotëruese ndaj të gjitha feve dhe mjafton Allahu si dëshmitar. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, duke e pohuar bindshëm këtë dhe duke e njësuar Allahun. Gjithashtu dëshmoj se Profeti ynë, Muhamedi - lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të - është robi dhe i Dërguari i Tij, më i miri prej krijesave të Tij. Mbi të qofshin lavdërimet dhe paqja, si dhe mbi familjen dhe shokët e tij.

E më pas:

Argumentet logjike dhe ato të transmetuara (Kurani dhe Suneti), shqisat dhe natyra e pastër, të gjitha këto dëshmojnë se Zoti ynë - i Lartmadhëruar - është i Vetëm në zotërimin e Tij, i njësuar në adhurimin e Tij. Pushteti i Tij është i plotë (mbi të gjitha krijesat), absolute është madhështia e Tij, pozita e Tij është e lartësuar, urdhëri i Tij është i zbatuar dhe bukuria e Tij është e përsosur. Është lartësuar mbi Arsh (Fronin e Tij madhështor) dhe përkujdeset për çështjet e robërve të Tij. Sunduesi i vërtetë, i Përherëshmi, që kujdeset për krijesat e Tij, është i Pasur dhe i

panevojshëm për të tjerë ndërsa çdo gjë është e varfër para Tij dhe çdokush është i nevojshëm për Të.

“Atij i kërkon çdokush që është në qiell dhe në tokë. Çdo ditë Ai është në një çështje të re” (Rahman: 29)

Fal gjynahet, largon fatkeqësitë, shëron dhimbjet, ndihmon të dobëtit, ndihmon nevojtarët dhe pasuron të varfërit. Ai cakton vdekjen e dhuron jetën, lumturon dhe trishton, humbet kë të dojë dhe udhëzon këtë dojë, disave u jep të mira dhe disave ua largon mirësitë, krenon disa njerëz dhe poshtëron të tjerë, disa i ngre dhe disa i ul. Duart e Tij janë plot bujari, natën dhe ditën, duke mos u pakësuar asgjë për shkak të dhënies së vazhdueshme. Ai është i Pari para të Cilit s’ka pasur asgjë dhe i Fundit pas të Cilit nuk mbetet asgjë. I Larti mbi të Cilin nuk është askush, i Afërti dhe më afër se Ai s’është askush (Domethënë që e ka rrethuar çdo gjë me dijen e Tij dhe mbikëqyrjen e Tij.) Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Tij dhe Ai është i Plotfuqishmi, i Urti.

Ai nuk ka portier që t’i marrësh leje për të hyrë tek Ai, e as roje që të pengon të arrish tek Ai. Nuk ka as ministër nëpërmjet të cilit mund të arrish tek Ai, as ndihmës që e ndihmon Atë. Nuk ka ndonjë të dashur e as ndërmjetës që të ndërhyjë tek Ai, veçse pasi Ai të jap leje për këtë, nuk ka as zëvendës që ia bën të njohura nevojat e robërve të Tij.

Ka përfshirë me dijen e Tij çdo gjë, asgjë nuk del nga mundësia e Tij (është i Plotfuqishëm të bëjë gjithçka) dhe mëshira e Tij ka përfshirë gjithçka. Atë nuk e angazhon një çështje nga një tjetër, e as nuk ngatërrohet nga kërkesat e shumta që i drejtohen. Nuk bezdiset nga lutjet e atyre që i luten pandërprerë dhe me ngulm. Sikur të mblidheshin të gjitha krijesat, i pari dhe i fundit prej tyre, njerëzit dhe xhinët, në një vend e t’i kërkonin Atij, e Ai t’i

jepte çdokujt prej tyre atë që kërkon, kjo nuk do ta pakësonte atë që gjendet tek Ai as sa një grimcë.

I Dëlirë nga çdo e metë e mangësi është Ai. Sa Madhështor që është! Urdhri i Tij kur dëshiron diçka i thotë: ‘Bëhu!’ dhe ajo bëhet. Perdja e Tij është prej drite, sikur ta zbulonte atë, shkëlqimi i fytyrës së Tij do të digjte gjithçka prej krijesave të tij.

Larg nga mëshira e Tij qofshin mohuesit zullumqarë!

Ai është Allahu, Zoti i botëve. **“Allahu është Ai që i ngriti qiejt dhe tokën pa shtylla të dukshme, pastaj u lartësua mbi Arsh. E nënshtroi diellin dhe hënën, çdonjëra prej tyre noton në një orbitë të caktuar. Ai i rregullon çështjet, i sqaron argumentet, në mënyrë që ju të jeni të bindur për takimin e Tij. Ai është i Cili e ka shtrirë tokën dhe ka vendosur në të male dhe lumenj dhe nga çdo fryt ka bërë dy lloje. Natën ia mbështjell ditës. Me të vërtetë në këto ka argumente për një popull që mendon.”** (Ra’d: 2-3)

“Ai i ka krijuar qiejt pa shtylla të dukshme, ka vënë male të palëvizshme në Tokë, që ju të mos lëkundeni dhe ka shpërndarë në të gjithfarë gjallesash. Ne e zbresim ujin nga qielli dhe bëjmë të rriten në të gjithfarëlloj bimësh të vlefshme. Ky është krijimi i Allahut, pa më tregoni çfarë kanë krijuar të tjerët veç Tij? Por zullumqarët janë në një humbje të qartë!” (Lukman: 10 - 11)

Të Dërguarit u thanë popujve të tyre: **“A ka dyshim në Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të tokës?!”** (Ibrahim: 10) Dmth: Ai është më i dukshmi e më i qarti se çdo gjë tjetër. Ekzistenca e gjërave varet nga ekzistenca e Tij. Ai është Dëshmuesi dhe për Të tregojnë dëshmitë. Ai është vetë argumenti dhe për të Cilin tregojnë argumentet. Ai është argument me Vetën e Tij, për Vetën e Tij. Siç ka thënë njëri prej dijetarëve: *“Si të kërkoj argumente për atë i Cili është argument për mua për çdo gjë. Pra çdo argument që*

të kërkosh për Të, ekzistenca e Tij është më e qartë se vetë argumenti”

I dëlirë nga çdo e metë është Ai për njëshmërinë e të Cilit dëshmojnë të gjitha krijesat. Ai madhësisë së Tij i përuken të gjitha qëniet, që për Të janë të varfër (nevojtarë) të gjitha gjallesat. Ata nuk zotërojnë për vetet e tyre dobi e as dëm, as vdekjen, as jetën e tyre e as ringjalljen. Ai i ngjall ata dhe i vdes, i zhduk ata dhe i mban në ekzistencë, i ruan ata dhe rregullon çështjet e tyre, i drejton ata dhe i nënshtron. Prej Tij është ekzistenca dhe prej Tij është mbajtja në jetë. **“Zoti ynë është Ai që i dha formë çdo gjëje (që e krijoi çdo gjë)”** (Taha: 50) **“Cilat fjalë pas atyre të Allahut dhe cilat argumente pas argumenteve të Tij po besoni?”** (Xhathijeh: 6)

“A ka dyshim në Allahun?!” Ai është aq i njohur saqë s`mund të mohohet dhe aq Madhështor sa nuk ka si të mos pranohet. “Asgjë s`mund të jetë e saktë në mendje, nëse dita ka nevojë për argumentim.”

Pra ekzistenca e Tij, e Zotit të Madhëruar e të Dëlirë nga çdo mangësi, Zotërimi i Tij, Fuqia e Tij, janë më të dukshme se çdo gjë tjetër në mënyrë absolute. Ai është më i qartë për mendjet se sa dielli për sytë. Ai është më i qartë për logjikën se sa çdo gjë që ato logjikojnë dhe pranojnë ekzistencën e saj. Atë nuk e mohon me gjuhën e tij veçse një kryeneç, ndërsa zemra e tij, mendja e tij dhe natyrshmëria e tij, të gjitha ato e përgënjeshtrojnë atë vet. **“A ka dyshim në Allahun?”**

Dyshim ka në ato gjëra që argumentet e tyre janë të fshehura dhe janë të vështira për t`u provuar, ndërsa Ai që në çdo gjë të prekshme, apo të logjikshme ka një argument, madje shumë argumente, që dëshmojnë se Ai është i Vetmi i Cili meriton adhurimin, Zoti i botëve, si mund të ketë dyshim në Të?!

Nuk ka në mesin e dijeve të cilat njerëzit i njohin, diçka më të shumtë, më të argumentuar dhe më të qartë se sa ajo që tregon për ekzistencën e Allahut, për njëshmërinë e Tij në Zotërim dhe për njëshmërinë e Tij në adhurim. I Lartmadhëruar dhe i Dëlirësuar është Ai nga çdo mangësi.

Çdo gjë të cilën e shikon me sytë e tu, e dëgjon me veshët e tu, apo e kupton me zemrën tënde dhe çdo gjë që e percepton me shqisat e tua, tregon për Allahun e Lartmadhëruar.

Pra rrugët e dijes që të çojnë te Krijuesi i Lartësuar janë të pamohueshme, nuk ka në ato aspak dyshim. Për këtë arsye të Dërguarit u thanë popujve të tyre: **“A ka dyshim në Allahun?!”** Ju drejtuan atyre ashtu siç i drejtohesh dikujt që nuk duhet t’i shkojë aspak në mendje dyshimi për mos-ekzistencën e Allahut të Dëlirë dhe të Lartësuar. Madje as në hyjninë e Tij, në zotërimin e Tij dhe në përsosmërinë e cilësive të Tij.

E megjithëse kjo çështje është nga më të dukshmet e më të qartat, përsëri janë shfaqur disa njerëz që kanë dalë kundër rrymës së përgjithshme, të cilët e kanë mohuar Krijuesin dhe janë bërë sprovë për disa prej muslimanëve fillestarë dhe të rinj dhe po zhvillojnë një luftë të ashpër ndaj tyre, duke u cënuar besimin dhe moralin e tyre. Prandaj, përballja me këtë sprovë dhe këtë “terrorizëm ideologjik” të shëmtuar, është prej përpjekjeve më të mëdha në rrugë të Allahut, sepse kjo zmbrajs njëherazi atë që sulmon fenë dhe dynjanë.

ÇFARË ËSHTË ATEIZMI?

Në përkufizimin terminologjik ateizmi është: Mohimi i ekzistencës së Zotit.

Ateistët janë ata që nuk besojnë në ekzistencën e Allahut të Madhëruarit, e aq më pak të pranojnë njëshmërinë e Tij në zotërim dhe në adhurim.

Ata thonë: Gjithësia u gjend aksidentalisht, nuk ka krijues dhe materia është e përhershme (pa fillim e pa mbarim), ajo është njëkohësisht krijesa dhe krijuesi. Për rrjedhojë ata i mohojnë të Dërguarit (profetët) dhe nuk i pranojnë fetë.

Në përgjithësi ata janë dy lloje:

Lloji i parë: Ata që nuk besojnë në ekzistencën e Allahut të Lartësuar.

Lloji i dytë: Ata që quhen agnosticistë (dyshues) dhe thonë: Nuk e dimë a ekziston Zoti Krijues apo jo?

Këta të dy i bashkon *mosbesimi* në Krijuesin e Lartmadhëruar, por grupi i dytë janë dyshues, ndërsa të parët janë të palëkundur¹. Në fakt studimi dhe realiteti na zbulojnë se shumica e mendimtarëve që kanë deklaruar ateizmin e tyre, nuk përqafojnë ateizmin implicit - sipas terminologjisë së tyre -, dmth: ata nuk janë mbështetur në teori shkencore, por janë ateistë eksplicitë (të jashtëm, negativë), kjo sepse ata vetëm shfaqin këmbënguljen e tyre, sepse nuk janë të bindur me argumentet e ekzistencës së Allahut.

¹ Sh.p.: të paktën ashtu shfaqen

Prandaj njëri prej filozofëve francezë, Maurice Blondel thotë: “*Nuk ekzistojnë ateistë me kuptimin e plotë të fjalës*”.

Dhe nuk janë larg nga këta që përmenda, një grup ateistësh të cilët e pranojnë një Krijues për gjithësinë, por pretendojnë se Ai hoqi dorë prej saj, apo u zhduk pasi e krijoi dhe e la të ecë vet! Sa absurditet i madh është ky! Allahu është i Dëlrësuar dhe larg kësaj që ata thonë.

Në Kuran tregohet se sa shpifje e madhe dhe e shëmtuar është fjala e atyre të cilët pretenduan se Allahu ka djalë: **“Dhe thanë: ‘I Gjithëmëshirshmi ka djalë!’.” Keni thënë një gjë shumë të madhe. Qiejt gatisa nukpëlcastin, toka gatisa nuk çahet dhe malet sa nuk lëvizin nga vendi nga kjo fjalë! Nga shpifja që ata bënë për të Gjithëmëshirshmin se Ai paska djalë!”** (Merjem: 88-91) E ç’mund të thuhet pastaj për atë që e mohon krejtësisht ekzistencën e Krijuesit?!

Është e ditur se ateizmi në të shkuarën ka ekzistuar fare pak. Ata që e kanë mohuar Allahun prej njerëzve kanë qenë një grup shumë i vogël. Më i keqi prej tyre ishte Faraoni i cili tha: **“E çështë Zoti i botëve?”** (Shuara: 23).

Këtë rrymë ndoqën një grup prej filozofëve dhe një grup prej idhujtarëve arabë të cilët quheshin “Ed Dehrijeh”. Këta janë ata që besojnë në “vjetërsinë” e botës (thonë se ajo s’ka as fillim e as mbarim) dhe e mohojnë Krijuesin.

Pra siç e shikojmë, mohimi i Krijuesit të Lartmadhëruar nuk ka gjetur pranim, apo përhapje të gjerë në mesin e njerëzve. Në lidhje me këtë, njëri prej historianëve grekë, Plutarku thotë: *“Kanë ekzistuar në histori qytete të pafortifikuara, qytete pa kështjella, qytete pa shkolla, por kurrë nuk kanë ekzistuar qytete pa faltore.”*

Ndërsa në kohët moderne çështja ka ndryshuar. Qysh pas

përfundimit të shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe fillimit të shekullit të tetëmbëdhjetë, me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë që po përjetonte perëndimi, filluan të shfaqen disa rryma që deklaruan mohimin e ekzistimit të Krijuesit. Kjo ishte koha e Darvinit, e Marksit, e Niçes dhe e Frojdit, të cilët i trajtuan dukuritë shkencore, psikologjike, ekonomike dhe shoqërore, me një metodë në të cilën nuk merrej në konsideratë ekzistenca e Krijuesit.

Për këtë ndihmoi pozicioni i brishtë i fesë së krishterë në periudhën e mesjetës dhe në shekujt pas saj, si pasojë e luftërave, inkuizicionit dhe krimeve që u kryen në Evropë në emër të fesë, në lidhje me sjelljen e kishës katolike kundrejt asaj që e quante herezi, apo devijim nga parimet e kishës.

Kjo ideologji nuk qëndroi vetëm tek shkencëtarët empirikë (eksperimentues), te psikologët dhe sociologët, por i tejkaloi ata dhe u përfshinë në të edhe shkrimtarët, të cilët shpallën atë që e quajtën: Ideja e vdekjes së fesë dhe Krijuesit dhe se feja i largoi njerëzit nga humanizmi i tyre, duke u detyruar atyre rregulla që binin ndesh me natyrën e njeriut, lirinë dhe lumturinë e tij.

Këto ide u përputhën me “studimet e famshme” të Darvinit të cilat binin ndesh drejtpërdrejt me teorinë e zanafillës së universit, që gjendet në librin e shenjtë të të krishterëve.

Gjithashtu Niçja bëri deklaratën e tij të famshme: “Vdekja e Zotit të madh” dhe tha gjithashtu: “Feja është një dogmë e kotë dhe krim ndaj njerëzimit”.

Kështu, idetë e ateistëve në këtë periudhë filluan të merrnin drejtimin e largimit nga feja, për shkak të përplasjes mes logjikës dhe veprimeve e mësimëve të kishës.

Ndërsa Marksit shpalli teorinë e tij të njohur: “Nuk ka Zot dhe

jeta është materie” dhe e konsideroi fenë: “Opium për popullin”, sepse ajo - sipas pretendimit të tij - e bën popullin dembel dhe mosbesues ndaj fuqive të tij për të ndryshuar realitetin.

Gjithashtu u shfaq edhe Frojdi me teorinë e tij, në të cilën ai pretendon se:

“-Feja është iluzion dhe se njerëzimi kishte nevojë për të në fillimet e tij”

Ai thoshte se: Ideja e ekzistencës së Zotit, është përpjekje e nënvetëdijes² për të arritur përsosmërinë të njeriut i cili është si zëvendësuesi më i lartë i personalitetit të babait. Sepse njeriu, - sipas tij - në vegjëli, e shikon babanë e tij si një njeri të përsosur dhe të jashtëzakonshëm, por pas një farë kohe kupton se përsosmëria nuk ekziston, kështu nënvetëdija përpiket të gjejë një zgjidhje për këtë krizë, duke krijuar një imazh imagjinar për diçka që quhet: ‘përsosmëri’.”

Përveç atyre që thamë më sipër shtojmë edhe faktin se Franca, pas Revolucionit Francez, u bë dëshmitare e disa ndryshimeve politike. E njëjta gjë ndodhi edhe në Britaninë e Madhe dhe në vende të tjera evropiane, ku mbizotëroi prirja për shkëputjen e fesë nga shteti.

Kështu filloi ateizmi bashkëkohor në perëndim dhe u përhap shpejt, deri sa arritëm në vitet e fundit, ku u ringjall fantazma e ateizmit, pas një periudhe letargjie, që vijoi pas rënies së shtetit

² Sh.p.: Nënvetëdija apo siç përdoret ndryshe subkoshienca (fr. subconsciousence, ang. underconsciousness)

është shtresa më e poshtme, më e ulët e vetëdijes së njeriut. Tërësia e përjetimeve psikike, të cilat në momentin e të menduarit, përkatësisht të qenurit i vetëdijshëm, nuk janë në qendër të vetëdijes por në thellësinë apo në periferinë e saj. Nënvetëdija ndikon në mënyrë të rëndësishme në formimin e jetës shpirtërore të njeriut. Nënvetëdija kultivon instikte, përjetime, etj, të cilat mund të manifestohen në raste të caktuara dhe të papritura.

që e mbronte atë dhe e mbështeste, Bashkimit Sovjetik.

Sipas statistikave, përhapja e ateizmit në botë po shtohet me ritme të frikshme. Një nga këto statistika e ka kryer organizata “Eurobarometer”, e cila është një nga organizatat më të mëdha në fushën e studimeve statistikore në Evropë. Sipas saj, në vitin 2005, rreth 18% e banorëve të Evropës ishin ateistë që nuk besonin në ekzistencën e Krijuesit, 27% prej tyre nuk besonin në Krijuesin por besonin në një botë shpirtërore, apo fuqi të mbinatyrshme. Statistika të tilla na sjell edhe organizata “Ipsos Reid”, e cila është e njohur në fushën e studimeve dhe anketimeve. Ajo përmend se numri i ateistëve në Kanada, në vitin 2011 kishte arritur në 43%. Po ashtu gazeta “Financial Times” përmend se në vitin 2006 rreth 65% e japonezëve ishin ateistë. Ndërsa statistikat e organizatës “Ingo” tregojnë se numri i ateistëve në Meksikë është më shumë se 5.2%.

Disa studime të tjera përmendin se përqindja e ateistëve në Kinë sillet diku te 8 - 14%, për të mos përmendur pastaj faktin se shumica e budistëve - të cilët janë të shumtë në numër - në thelb janë ateistë.

Ndërsa kanali BBC ka arritur në përfundimin se 9% e amerikanëve janë ateistë. Ashtu siç përmendin disa studime të tjera zyrtare dhe gjysmëzyrtare - se ateizmi në Shtetet e Bashkuara po rritet me shpejtësi dhe se 55% e ateistëve dhe agnosticistëve kanë moshë më të vogël se 35 vjeç, dhe se universitetet amerikane janë një tokë pjellore për përhapjen e kësaj rryme.

TË GJITHA KËTO STUDIME FLASIN PËR JOMYSLIMANËT, POR SI ËSHTË GJENDJA NË BOTËN ISLAME?

Ai që studion historinë islame do të gjejë raste të veçuara dhe të rralla të disa njerëzve që u kthyen në ateistë. Nga më të njohurit prej tyre përmendim: Ibn Rauendij, i cili ishte çifut, pastaj shfaqti përfaqimin e fesë Islame, pastaj u rikthye në judaizëm, pastaj kaloi në ateizëm.

Ndërsa ateizmi me petkun e tij të ri, hyri në botën islame në mesin e shekullit të 19-të, i mbështetur nga kolonializmi dhe i mbuluar fillimisht me pretendimin e ecjes drejt perëndimit dhe thirrjen për emancipim, racionalizëm dhe iluminizëm, e duke përfunduar në ateizëm dhe mohim të ekzistencës së Allahut të Lartmadhëruar.

Historia bashkëkohore është e mbushur me emra të shumtë të cilët i rezervuan vetes një vend në “regjistrin e errët” të ateizmit. Ata janë njerëz që thërrasin në të me entuziazëm dhe që shpalojnë bazat dhe principet e tij duke u përpjekur që t’i rrënjosin ato në vendet islame.

Nuk mendoj se ka ndonjë që është i pavëmendshëm ndaj faktit se: bota islame pashmangshëm do të ndikohet nga kjo baticë e ateizmit perëndimor, duke parë këtë afrim të madh dhe këto kontakte të shumta që janë vendosur mes popujve në kohën moderne.

RRYMAT ATEISTE

Nuk ka ndonjë rrymë të ateizmit që i mbledh të gjithë ateistët nën ombrellën e saj, por në përgjithësi ata mund t’i klasifikojmë

në dy rryma kryesore:

1. *Rryma shkencore eksperimentale*
2. *Rryma ideologjike filozofike*

Nga këto të dyja u shfaqën shkolla të mendimit, të cilat lëndën e tyre të parë e marrin nga ateizmi.

Prej këtyre shkollave mund të përmendim:

“Laicizmi”, i cili do të thotë: Ndërtimi i shoqërisë mbi baza materialiste me të cilat feja s’ka asnjë lidhje.

“Ekzistencializmi”, për tek i cili thërriti Sartri dhe të tjerë përveç tij. Kjo rrymë predikon shfaqjen e vlerave të individit dhe bën thirrje për lirinë e tij, dhe se njeriu është në gjendje të bëjë atë që dëshiron.

“Pozitivizmi” për tek i cili thërriti August Kanti dhe bashkëmendimtarët e tij. Ajo është një rrymë filozofike, që refuzon çdo lloj njohurie përtej asaj eksperimentale dhe të perceptueshme nëpërmjet shqisave.

“Komunizmi” të cilin e themeloi Karl Marksi, e cila thotë se nuk ka Zot dhe se jeta është vetëm materie.

“Darvinizmi” i cili pohon teorinë e evolucionit.

Nuk harroj të përmend këtu edhe një rrymë të kotë ateiste që është përhapur në botë dhe ka arritur të depërtojë deri në zemër të botës islame. Bëhet fjalë për **“adhuruesit e djallit”** (satanistët), e cila është një lëvizje ateiste në filozofinë e saj, paganiste në ritet e saj, me mbështetje (financiare) jehudije, e cila mohon Zotin e Lartmadhëruar dhe refuzon të gjitha fetë. Ajo nuk ka qëllim tjetër përveçse rebelimit dhe shfrenimit, madje në forma dhe mënyra anormale dhe aspak të natyrshme. Të flasësh rreth satanizmit ka nevojë për shtjellim të mëtejshëm duke parë dëmin e tij të madh për individin dhe shoqërinë.

Ndërsa disa studiues të tjerë e ndajnë ateizmin - në bazë të motiveve që shtyjnë për tek ai, në tre kategori:

I pari: **Ateizmi emocional**. Shtysa e tij është keqkuptimi i paracaktimit (kaderit).

I dyti: **Ateizmi utilitar**. Shtysat e tij janë dëshirat e pandalshme dhe rendja pas epsheve e kënaqësive pa kufij.

I treti: **Ateizmi logjiko-shkencor** dhe shtysa e tij janë pikëpamjet e tyre të pretenduara filozofike apo shkencore.

Sido që të jetë, pa marrë parasysh a janë këto ndarje gjithëpërfshirëse apo jo, përsëkrimi i përbashkët i këtyre rrymave ateiste është: mosbesimi në Krijuesin e Lartmadhëruar. I Dëlirë dhe i Madhërishëm është Ai, në lidhje me atë që ata i shpifin.

Tema e ateizmit është e gjerë dhe ka shumë degëzime, por pas kësaj hyrjeje që na njohu me ateizmin, shtjellimi i saj mund të përmblihet në katër kapituj kryesorë. Unë do të përpiqem me lejen e Allahut t'i sqaroj dhe t'i përmbledh çështjet e tij të shpërndara, nën dritën e fjalëve të dijetarëve të mëparshëm dhe bashkëkohorë, si edhe duke u mbështetur në shkrimet e studiuesve të cilat janë botuar, apo që janë publikuar në rrjetin e internetit, si dhe nëpërmjet argumenteve që mua më janë bërë të qarta pas meditimit, studimit dhe analizës. Allahu është Ai prej të cilit kërkoj ndihmë!

KAPITULLI I PARË

SHKAQET QË ÇOJNË DREJT ATEIZMIT

Ateizmi bie ndesh me natyrën e pastër njerëzore, bie ndesh me logjikën, e megjithatë ai është përhapur në botë në përgjithësi, madje ka gjetur shteg edhe për në vendet islame. Dhe kjo për disa shkaqe:

Shkaku i parë: Inferioriteti kundrejt “civilizimit”, i cili ka mbizotëruar shpirtat e shumë prej djelmoshave të rinj. Kjo gjë i ka shtyrë ata t'i nënçmojnë vlerat e popullit të tyre dhe trashëgiminë fetare. Nga ana tjetër, kjo ka bërë që ata ta shohin me mahnitje dhe madhërim perëndimin, të cilin e shohin shumë të përparuar dhe mendojnë se shkaku i përparimit të tyre material është ateizmi i tyre!

Shkaku i dytë: Ky është një shkak i rëndësishëm për tu trajtuar. Bëhet fjalë për: Moskuptimin e drejtë të çështjes së paracaktimit hyjnor (Kada dhe Kader), sidomos ajo që lidhet me arsyet dhe urtësitë e veprave të Allahut të Lartmadhëruar.

Shkaku i tretë: Shpëlarja e trurit që u është bërë atyre që jetojnë në mesin e pabesimtarëve qofshin ata vendas, turistë, apo që shkojnë për arsye nga më të ndryshmet si: arsimimi,

specializimet në fusha të ndryshme etj, të cilëve vazhdimisht u hidhen dyshime në lidhje me besimin e tyre dhe që jorrallëherë i gjejnë të papërgatitur për t'u ballafaquar me to.

Nuk duhen nënvlerësuar kurthet që pabesimtarët ngrenë ndaj muslimanëve, sepse me të vërtetë ata ngrenë kurthe të mëdha.

“Dhe ata ngritën kurthet e tyre, por kurthet e tyre janë tek Allahu, edhe në qofshin kurthet e tyre aq të fuqishme sa t'i bëjnë malet të lëvizin nga vendi” (Ibrahim: 46)

Shkaku i katërt: Dëshira për plotësimin e qejfeve tej kufijve, dhënia pas tekave dhe shfrenimit moral, ose siç quhet ndryshe: degjenerimi moral. Këto të dyja (shthurja dhe ateizmi) bashkëjetojnë mirë me njëra-tjetrën, sepse kështu, nuk ka më gjëra të ndaluara apo të lejuara nën ombrellën e ateizmit. Gjithashtu nuk ka mbikëqyrje, llogaridhënie e as shpërblim apo ndëshkim. Nuk ekziston më ajo që quhet në gjuhën e sotme: brerje ndërgjegjeje, dmth shpirti qortues, i cili e godet muslimanin me “kamxhikun” e pendesës pas kryerjes së veprave të shëmtuara.

Prandaj shumë prej atyre që anojnë kah ateizmi, kanë si shtysë tekat dhe dëshirat epshore, e asgjë tjetër. Dhe këtë çështje dijetarët e kanë përshkruar duke thënë: *“Epshti është sapuni i dyshimit”*. Dmth epshti ia bën të lehtë dyshimit kalimin dhe depërtimin në shpirt.

Shkaku i pestë: Paqartësitë dhe kundërthëniet që duket sikur ekzistojnë në fe, sipas këndvështrimit të ateistit. Diçka e tillë në raport me doktrinën e krishterë është e kuptueshme, ndërsa në raport me Islamin këto dyshime dhe paqartësi vijnë më së shumti për shkak të besëtytnive që praktikohen dhe përhapen nga sekte të devijuara dhe që më pas ato besime të kota i atribuohen padrejtësisht Islamit.

Shkaku i gjashtë: Injoranca rreth njohjes së Islamit dhe mirësisë të tij. Ata nëse do ta studionin këtë fe madhështore, do t'u mjaftonte kundrejt çdo teorie, ideje, apo filozofie, por ata janë siç ka thënë një poet:

“Si deveja në shkretëtirë që etja e vret ndërsa uji mbi shpinën e saj është i mbartur.”

Shkaku i shtatë: Dhe ky është më i rëndësishmi, i cili ka të bëjë me vetë ateistin: Mendjemadhësia. Nuk ka mohuar dikush e të jetë kthyer në mosbesim³ veçse për shkak të mendjemadhësisë që ka në vetvete, sepse Allahu i Lartmadhëruar thotë: **“Ata që debatojnë rreth argumenteve të Allahut pa pasur ndonjë fakt që u ka ardhur atyre, ata nuk kanë tjetër në shpirta veçse pretendim tëmadhështisë, të cilën ata nuk do ta arrijnë”** (Ghafir: 56)

Kjo mendjemadhësi jep disa fryte të këqija:

Së pari: I ka shtyrë të mohojnë fenë e Allahut. I Lartësuar thotë: **“...Por ata mohuan atë që nuk e përfshinë me dijen e tyre.”**⁴ (Junus: 39)

Së dyti: Injorimi dhe refuzimi i dëgjimit të së vërtetës. Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe atyre nuk u vjen ndonjë argument nga Zoti i tyre, veçse ata ia kthenin shpinën atij”** (Jasin: 46)

Së treti: Vetëpëlqimi me diturinë e falimentuar që ata kanë, me të cilën refuzojnë dispozitat e Allahut. I Lartësuar thotë: **“Kur atyre u erdhën të Dërguarit e tyre me argumente, ata iu gëzuan diturisë që kishin, kështu e merituan atë (dënimin) me të cilin ata talleshin”** (Gafir: 83)

³ Sh.p.: pas besimit me të cilin lind njeriu

⁴ Sh.p.: E mohuan Kuranin pa e studiuar më parë atë

Së katërti: Pasimi verbërisht i parisë udhëheqëse që thërrasin në mosbesim.

I Lartësuar thotë:

“Kështu Ne nuk dërguam para teje në ndonjë qytet ndonjë të Dërguar, veçse njerëzit që jetonin në luks prej tyre thanë: ‘Ne i gjetëm baballarët tanë në këtë fe dhe ne në gjurmët e tyre do të ecim’.” (Zukhruf: 23)

Së pesti: Dhe fryti i fundit është devijimi, pra nëse njeriu anon nga devijimi lihet në zgjedhjen e tij, madje i shtohet edhe më shumë devijimi, ashtu siç Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur ata devijuan, Allahu ua devijoi zemrat e tyre”** (Saff: 5)

IDEOLOGJIA MBI TË CILËN ËSHTË NGRITUR MENDIMI ATEIST DHE NË ÇFARË I THËRRET NJERËZIT

Së pari vlen të theksohet se: ideologjia ateiste nuk ka një teori të plotë, nëpërmjet së cilës ajo të jetë në gjendje të shpjegojë të gjitha dukuritë që nga fillimi deri në fund dhe t'u përgjigjet të gjitha pikëpyetjeve enigmatike. Ajo që ateistët u paraqesin njerëzve është një grumbull dyshimesh dhe supozimesh që nuk e kënaqin mendjen dhe nuk janë bindëse.

Ata përpiqen ta mbështesin ideologjinë e tyre me një teori shkencore këtej dhe një filozofi andej, dhe kështu kanë ngatërruar mes këtyre të dyjave dhe kanë dalë pastaj nga kjo përzierje, me një dogmë të shpërftyruar dhe të deformuar e cila nuk është aspak bindëse.

Nëpërmjet studimit gjejmë se ateistët e bazojnë ideologjinë e tyre mbi dy baza:

E para: Teori shkencore eksperimentale**E dyta: Teori ideologjike filozofike**

Këto dy baza duhen sqaruar mirë, në mënyrë që ta kuptojmë ateizmin në mënyrë të saktë dhe në thellësi.

BAZA E PARË: TEORITË SHKENCORE EKSPERIMENTALE

Pas hulumtimeve del se teoritë shkencore eksperimentale mbi të cilat mbështetet ateizmi janë dy llojesh: **Lloji i parë: Teori shkencore të pavërteta.** Shumë prej atyre teorive që mbushën botën me poteret e tyre në dy shekujt e kaluar, kanë filluar të rrëzohen dhe vendin e tyre po e zënë tanimë, teori që përputhen me realitetin e besimit fetar. Aktualiteti është dëshmitar i asaj se teoritë e reja shkencore janë larg ateizmit dhe më pranë besimit. Në një kohë që feja e Allahut dhe për këtë lavdërimi i takon Allahut, është e qëndrueshme, e pandryshueshme, sepse ajo është shpallje nga Allahu.

Pastaj, nëse supozojmë se ato teori janë të vërteta, ato prapë mbeten teori të mangëta, nuk janë gjithëpërfshirëse, nuk shpjegojnë çdo gjë dhe për këtë së shpejti do të sjellim shembuj konkretë.

Lloji i dytë: Teori të sakta, por që janë larg shpjegimit të shkaqeve dhe lidhjeve që ekzistojnë mes krijesave, edhe nëse ato teori shoqërohen me stërhollimet e tyre filozofike.

E megjithatë në fund ato nuk ofrojnë shpjegim të plotë për ekzistencën e këtij universi në këtë formë të saktë, me këto ligje të qëndrueshme pa një Krijues, Rregullues dhe Sistemues të Urtë e të Dijshëm, ashtu siç ata pretendojnë.

I gjithë problemi tek ata lind nga fakti se ata nuk duan ta pranojnë lidhjen ndërmjet shkaqeve dhe shkaktuesit të tyre, si dhe ndërmjet krijesave dhe Krijuesit.

Teoritë më të rëndësishme të tyre ishin:

Teoria e parë: Teoria e Darvinit. Këtë teori ai e ka shpjeguar në librin e tij “Origjina e specieve”, libër i cili u bë gurë-themeli i teorisë ateiste të evolucionit. Darvini e ngriti idenë e tij mbi bazën e asaj se gjallesat nuk janë krijuar çdonjëra prej tyre në mënyrë të pavarur, por ato kanë një origjinë të përbashkët e cila është qeliza e thjeshtë. Kjo qelizë pastaj ka vazhduar të evoluojë dhe të përparojë si gjallesë, etapë pas etape, derisa u bë njeriu dhe gjallesat e tjera. Dhe natyra, gjatë kësaj kohe zgjidhte më të fortin për mbijetesë. Këtë ai e quajti: “përzgjedhja natyrore” ose “mbijetesa e më të fortit”.

Ideologjia darviniane ka mbledhur ateistët më të mëdhenj të botës, të cilët pretendojnë se njeriu nuk ka një Krijues dhe se ai është produkt i një evolucionit natyror miliona vjeçar dhe se ai është ngritur dhe ka mbizotëruar mbi llojet e tjera të ndryshme të gjallesave.

Ateistët i kanë dhënë rëndësi të madhe kësaj teorie, sepse ajo sipas tyre është teoria e vetme e aftë për të shpjeguar gjithësinë dhe jetën pa pasur nevojë për një Krijues. Por në realitet ajo s’është tjetër veçse një hipotezë e brishtë, e dobët dhe pjesët e saj nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën. Për këtë arsye ajo është zbehur dhe është venitur shumë në kohën tonë.

Rrëzimi i kësaj teorie, nëpërmjet fjalëve të shkencëtarëve dhe studiuesve kritikë, mund të përmbliidhet në pikat e mëposhtme:

Së pari: Ajo është teori e mangët, sepse nuk shpjegon të gjitha format e jetës në këtë gjithësi. Psh: ajo nuk jep shpjegim për

prejardhjen e insekteve, kur dihet se ato përfaqësojnë 80% të gjallesave në tokë dhe përse nuk është zbatuar mbi to ligji i evolucionit.

Siç nuk jep shpjegim as për zogjtë. A kanë evoluar shpendët të cilët fluturojnë? Cila ishte origjina e tyre?

Dhe gjëra të tjera që lidhen me gjallesat të cilat kjo teori i ka lënë në harresë. E çfarë vlere ka një teori që nuk shpjegon 90% të formave jetësore, të cilat supozohet që ajo t'i trajtojë dhe t'u japë përgjigje?!

Së dyti: Përfaqësuesit dhe përkrahësit më të mëdhenj të kësaj teorie ishin të paaftë të sqaronin mënyrën e transferimit të jetës nga gjëja e ngurtë në krijesë të gjallë. Kështu nëse i pyet ata: Si erdhi jeta papritmas nga një qelizë e ngurtë në krijesën më të lartë të gjallë, e cila ka ndjenja dhe logjikë!? Ateisti dhe “teoria” e tij të përgjigjet: Ky evoluim ndodhi befás! Rastësisht!

Diht se “rastësisht” nuk është përgjigje shkencore, përkundrazi ajo është një përgjigje që bie ndesh me dijen, siç do ta qartësojmë së afërmi - me lejen e Allahut.

Së treti: Nëse mediton gjërat mbi të cilat bazohet kjo teori, do të gesh se ajo niset nga ekzistenca e ngjashmërive mes gjallesave, prandaj Darvini ka menduar se origjina e njeriut është një majmun, për shkak të ngjashmërisë.

Ia vlen të përmendet me këtë rast, një pjesë poezie që ka shkruar ateisti “Ez Zehauj”, ku ai mburret se e ka prejardhjen nga një lloj majmuni i zhdukur dhe thotë:

*“Ne s’jemi gjë tjetër veç majmunë, nga një lloj majmuni i zhdukur.
Mburrje për ne është ngritja jonë, në shkallët e kuptimit”*

Them: Kjo teori pretendon se ekzistenca e sëmundjeve të përbashkëta mes njeriut dhe kafshëve, tregon se ka ngjashmëri

mes tyre. Dhe këtu pyeten përkrahësit e këtij mendimi: Përse të mos ketë ardhur njeriu nga miu dhe jo nga majmuni, kur dihet se ata të dy kanë shumë sëmundje të përbashkëta, siç është për shembull kanceri?!⁵ Dhe përgjigje prej tyre nuk ka.

Prej çudirave të kësaj teorie përmendim gjithashtu: Pretendimin e tyre se organet që nuk janë të përdorshme, zhduken me kalimin e kohës dhe trashëgohen ashtu të fshehura tek brezat e ardhshëm; ndërsa ato që përdoren, forcohen dhe evoluojnë. Prandaj thonë: Qafa e gjirafës është bërë e gjatë sepse ajo kishte nevojë të hante nga pemët dhe kështu zgjaste qafën, pastaj u zhvillua edhe më shumë derisa iu bë qafa e gjatë!

Pyetja që u bëhet atyre është: Përse nuk është zgjatur qafa e dhisë, kur dihet se asaj i pëlqen shumë të hajë gjethet e pemëve dhe ajo e zgjat qafën e saj qysh prej mijëra vjetësh?

Përsëri s'ka përgjigje!

Darvini thotë gjithashtu se *paraardhësit tanë e kishin trupin të mbuluar me lesh të dendur dhe se kur evoluuan dhe u shndërruan në njerëz me këtë formë që kanë sot, u zhdukën shumë prej qimeve nga trupi i tyre për shkak të mospërdorimit apo për shkak të mungesës së nevojës për to.*

Por kur deshi të shpjegonte mungesën e qimeve tek gratë siç është te burrat, sollti një justifikim të çuditshëm, duke pretenduar se kjo është e domosdoshme për bukurinë e gruas dhe që ajo të jetë sa më tërheqëse! *Kjo arsye mund të ishte e pranueshme nëse ai që e shikon këtë temë beson në ekzistencën e një Krijuesi të Urtë, por ateistët nuk e pranojnë këtë gjë!*

⁵ Sh.p.: Për këtë arsye siç e keni vënë re, shkencëtarët që merren me eksperimentimin e sëmundjeve dhe ilaçeve, i injektojnë ato së pari tek minjtë, për shkak të ngjashmërisë së madhe që ka mes organizmit të tyre dhe atij të njeriut.

Po ashtu, Darvini u përpoq të shpjegonte ekzistencën e qimeve në pjesën e kokës së njeriut dhe arsyeën përse ato nuk u zhdukën bashkë me qimet e tjera të trupit, gjatë evoluimit të tij imagjinar dhe tha: *“Duke qenë se koka është e ekspozuar shumë ndaj goditjeve, ishte e domosdoshme që të mbetej floku në të (për ta mbrojtur!)”*

O Zot sa e çuditshme! Po balli dhe hunda, të cilat janë edhe më shumë të ekspozuara ndaj goditjeve dhe përplasjeve?! (Përse s’ka flokë mbi to?!)

Po qimet e brendshme të trupit? Edhe ato për këtë qëllim mbetën dhe nuk u zhdukën?!

Në mënyrë të përmbledhur themi: Kjo është një teori e dobët dhe e rrënuar.

Teoria e dytë: “Big bang”-u (Shpërthimi i madh)

Në mënyrë të përmbledhur kjo teori thotë se: Origjina e universit ishte një pikë e vetme, e vogël sa maja e një gjilpëre, e cila notonte në askund dhe asnjë-kohë. Pastaj papritmas, ajo shpërtheu, para 15 miliard vjetësh. Nga ky shpërthim, gradualisht u formua kjo gjithësi. Kështu pra, origjina e këtij universi nuk ishte gjë tjetër veçse maja e një gjilpëre!

Pyetja që do të mbetet si “kamxhik” që godet shpinat e ateistëve është:

Nga erdhi kjo majë gjilpëre?

Kësaj nuk i janë përgjigjur ende dhe as që do t’i përgjigjen ndonjëherë.

Pastaj: Përse ajo majë gjilpëre qëndroi e palëvizshme, pastaj vendosi papritmas të shpërthente?!

Çfarë e dallon pikërisht këtë çast në të cilin ajo shpërtheu nga të tjerët?! (Përse shpërtheu pikërisht në atë çast dhe jo në një çast tjetër?!)

Pastaj: Si mundet që një shpërthim të prodhojë një rend të përsosur?! A mund të ndodhë që shpërthimi vetë të sjellë rend të harmonizuar?!

Pastaj: Si erdhi jeta, logjika dhe ndjenjat nga një pikë e lëndës së ngurtë?!

Ateisti përgjigjet: Ndodhën disa reaksione që prodhuan disa qeliza, të cilat u bashkuan dhe u formuan pas shpërthimit me këtë rend të përsosur në çdo gjë.

Dhe kur pyetet: Si ndodhi ky bashkim i këtyre qelizave? Dhe si erdhi jeta nga gjëja e ngurtë?

Ateisti të përgjigjet me naivitet: Kjo ndodhi vetvetiu, ashtu rastësisht!

Tek ateistët, rastësia është zoti i botëve, i cili ka krijuar këtë univers! Sepse tek ata të gjitha dukuritë lidhen me të. Rastësisht u gjend qielli dhe atmosfera, u gjend presioni i ajrit. Rastësisht u gjendën gazet, u gjendën retë, u gjend një tokë e përshtatur për jetën, u gjendën lumenjtë, u gjendën detet, u gjendën peshqit dhe po rastësisht u gjend njeriu. U gjendën organet që i duheshin atij: u gjend dëgjimi, shikimi, u gjend një zemër që rreh, u gjendën rruazat e kuqe dhe të bardha të gjakut në sasinë e duhur. E mbi këto të gjitha: u gjend logjika dhe ndjenjat. Të gjitha këto ndodhën, sipas ateistëve, rastësisht!

Nuk dyshon asnjë i logjikshëm se ligji i rastësisë është i kotë, sepse rastësia nuk mund të sjellë rregull të përsosur.

Le të japim një shembull: Supozojmë se kemi vendosur një grup majmunësh në një dhomë dhe vendosim para tyre disa makina shkrimi dhe disa fletë që të luajnë me to, pastaj kthehemi tek ata pas një farë kohe. A mendon se do të gjejmë tek këto makina shkrimi, ndonjë poezi romantike të mrekullueshme e

cila konkurron poezitë e poetëve të mëdhenj?!

Një shembull tjetër: Po të vendosnim makinën e shkrimit përpara një foshnje që luan me të, pastaj e shikojmë fletën pas një farë kohe, a ka mundësi të gjejmë se ai ka shkruar në të një ekuacion matematikor të gradës së dytë, madje edhe e ka zgjidhur atë?!

Një shembull i tretë: Nëse vendosim në një kuti disa pusulla të vogla, ku tek çdo njëra nga të cilat është shkruar një shkronjë, pastaj e tundim kutinë fort, pastaj e hapim. A mund ta besojë dikush që ka logjikë se shkronjat janë grumbulluar dhe kanë formuar një fjalim entuziast madhështor?

Shembulli i katërt: Po të hedhim pas shpinës sonë gurë njëri pas tjetrit, a është e mundur që kur të kthejmë kokën pas të gjejmë një shtëpi të bukur?!

Përgjigjja e pyetjeve të mësipërme, për çdo njëri të logjikshëm, do të jetë: “Jo”, ndërsa tek ateistët: “Po”!!

Kam hasur se njëri prej ateistëve me emrin: Ismail Ed’hem i cili ka vdekur në vitin 1940, ka shkruar një libër të cilin e ka quajtur: “Përse jam ateist?”!! Në të cilin ai mbron me zjarr, ligjin e rastësisë. Ai thotë se *bota është si një shtypshkronjë në të cilën ka një milion nga çdo shkronjë e alfabetit. Këto shkronja pastaj fillojnë të lëvizin dhe të përplasen me njëra-tjetrën, afrohen, largohen e shkëputen, në një rreth vicioz pa mbarim. Dikur do të dalë libri: “Origjina e specieve” të cilin e shkroi Darvini, madje të gjithë librat do të fillojnë të shfaqen, duke iu nënshtruar supozimeve dhe mundësive të pafundme.*

Kështu “me këtë lehtësi!” është e mundshme për të, pasi i trazon këto shkronja, të na dalin të gjithë librat!

Dhe këto nuk janë aspak fjalët e një njeriu që ka probleme mendore, apo të një njeriu mendjelehtë, përkundrazi këto janë fjalët e një njeriu që është doktoruar në matematikë dhe flet tetë

gjuhë. E megjithatë ai thotë këto fjalë të cilat i refuzon çdo njeri i logjikshëm, madje edhe budalla, por ky është ateizmi, i cili e shndërron njeriun në krijesën më të pa mend në mënyrë absolute. Pastaj, vetëm këto fjalë të atij mjaftojnë për ta rrëzuar ateizmin e tij nga themelet. Ai pretendon se këto shkronja kur lëvizin dhe përplasen do të sjellin të gjithë librat. Mirë! Por kush është ai që i lëvizi ato?! Atëherë ato kanë nevojë dhe kjo është afër mendjes, për dikë që t'i lëvizë dhe për dikë që e mbush bojën pasi ajo të mbarojë, kanë nevojë për një vend ku të mblidhen ato shkronja, kanë nevojë për atë që do t'i rendisë faqet në atë mënyrë që çdo faqe të ketë numër të barabartë rreshtash, pastaj ka nevojë për dikë që t'i ndajë librat dhe ta lidhë secilin mëvete.

Kështu që nuk mjaftoi vetëm rastësia për nxjerrjen në dritë të librave, por duhej fuqi, duhej vullnet dhe urtësi, dmth ka nevojë për një veprues, të aftë dhe të mençur.

Medito pak në shembullin e mëparshëm të hedhjes së gurëve, po t'i ndërronim gurët me vezë psh, a do të ndërtohej shtëpia? Përgjigjja e sigurtë është: "Jo"

Pra, kërkohet projektim dhe mençuri.

Kështu është çështja edhe me grimcat e universit (atomet), ato janë të bashkuara mes tyre me urtësi, kështu që nëse ato bashkohen në një mënyrë të caktuar formohet ari, e nëse bashkohen në një mënyrë tjetër formohet uji, e kështu me radhë.

Të gjithë të mençurit janë dakort se rastësia nuk prodhon rregull dhe ajo nuk mund të përsërisë një rregull të njëjtë dhe nuk ka mundësi të shfaqet gjithmonë në të ndikimi i qëllimit.

E vërteta që s'mund të mohohet është se: ateisti është njeriu më i pamend në çështjen më të rëndësishme edhe nëse është i zgjuar në të tjerat. Allahu e mëshiroftë imam Dhehebiun kur tha në fund

të biografisë së “Ibn Rauendit” i cili ishte ateist dhe njëkohësisht shumë i zgjuar: *“Allahu e mallkoftë atë zgjuarsi pa besim dhe Allahu qoftë i kënaqur nga naiviteti i shoqëruar me devotshmëri”*⁶

Larg gënjeshtërisë së krijimit të rastësishëm, e gjejmë në Kuran të sqaruar në pak fjalë sqarimin e realitetit të krijimit, ku i Lartësuari thotë: **“A mos u krijuan ata nga hiçi?! Apo ata janë krijuesit?! A mos i krijuan ata qiejt dhe tokën?! Por jo, ata nuk janë të bindur.”** (Tur: 35-36)

Këtë e kuptoi një arab i shkretëtirës i cili nuk kishte diplomë në matematikë e as nuk kishte studiuar teoritë e Niçes, të Lavoisier-it, të Darvinit apo të tjerëve, por kur u pyet: *“Si e njohe Zotin tënd?”* ai krejt natyrshëm u përgjigj:

“Kur shohim gjurmë, kuptojmë që dikush ka shkuar, kur shohim një vijë uji, kuptojmë se nga një burim ka buruar. Po detet plot ujë e dallgë dhe toka me male e pyje, a nuk dëshmojnë se ka një Krijues të ditur, që i krijoi ato dhe qiellin me yje?!”

Kjo natyrshmëri tregon se çdo vepër e ka një veprues dhe çdo krijesë e ka një krijues. Psh nëse dikush e godet një fëmijë fshehtasi, ai me siguri do të kthehet dhe do të thotë: *Kush më goditi?* Sepse ai e di natyrshëm se çdo veprim duhet patjetër të ketë vepruesin edhe pse ai kurrë s’e ka studiuar teorinë e shkaktuesit. Por kjo është natyrshmëria e pastër njerëzore: **“...natyra e pastër në të cilën Allahu i krijoi njerëzit, nuk ka ndryshim të krijimit të Allahut”**⁸(Rum: 30)

⁶ Sijer al’lamin nubela (62 /14)

⁷ “Nefhut tijb” (289/5)

⁸ Sh.p.: Kanë thënë në komentën e këtij ajeti: Allahu i krijoi njerëzit muslimanë, pastaj u erdhën shejtanët dhe e tjetërsuan këtë natyrshmëri të pastër me besime dhe fe të devijuara.

Ndërsa ateistët janë njerëz natyrat e të cilëve janë shpërfytyruar: **“Dhe atë që Allahu dëshiron ta sprovtojë, ti nuk posedon për të asgjë tek Allahu”** (Maideh: 1).

Sa mirë e gjen të shprehur këtë realitet në fjalët e poetit:

*Thuaji foshnjës që sapo lind, fillon e qan pa pushim:
Kush të bëri të qash, kush ta mësoi këtë aktrim?!
Kur ta shohësh gjarprin, helmin e tij ta hedhë me furi,
Pyete: kush të krijoi me helm në brendësi?!
E pyete: o gjarpër si ja bën për të jetuar,

Me helmin vdekjeprurës, që në gojë e ke strehuar?!
Pyeti barqet e bletëve: mjalti nga ju si pikoi?!
E mjaltit thuaji: kush të ëmbëltoi?!
Qumështin steril, që në brendinë,
Me gjak e fekale të bagëtisë që strehuar,
Pyete: kush të bëri të kulluar?!

Rezen e diellit që nga skajet drejt tokës udhëton,
Pyete: në rrugën për tek njerëzit kush të orienton?!
Hënë kur ta shohësh të vezullojë,
Pyete: Kush bëri që drita jote të ndriçojë?!
O njeri, përmbahu, bëj kujdes, ku po shkon?
Nga Zoti yt i Lartmadhëruar ç'po të çorienton?*

KAPITULLI I DYTË

TEORITË FILOZOFIKE

Teoritë filozofike më kryesore ku ata bazohen, janë:

E PARA: MBIVLERËSIMI I MENDJES

Ateisti kujton se me mendjen e tij mund të arrijë të perceptojë gjithçka. Ai është i mendimit se shqisat e tij janë të afta të perceptojnë çdo gjë që ekziston (ndërsa çfarë shqisat nuk e perceptojnë, sipas tij, ajo nuk ekziston). Natyrisht që kjo bindje e tyre është e gabuar dhe në kundërshtim të plotë me logjikën e shëndoshë. Kjo pasi është e pamundur për mendjen njerëzore që të ketë njohuri për gjithçka.

Ibën Batah (Allahu e mëshiroftë!), transmeton se një burrë shkoi bashkë me djalin e tij tek Abdullah ibn Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), dhe i tha: *“Këtij djalit tim, ia kanë shastisur mendjen debatet e shumta, polemikat ia kanë çoroditur zemrën ndërsa*

filozofitë e kanë larguar nga Zoti i tij.” Abdullah bin Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i drejtohet djaloshit dhe i thotë: “O djali i vëllait tim, pa hidhe shikimin tënd atje në horizont e më thua, kush është ai njeri? – Tha: “Ai është filani.” – Ibn Abbasi i tha: “Të vërtetën e the. Tani më thua, çfarë është ajo pamje e zymtë që gjendet pas tij? – Djaloshi tha: “Nuk e di.”

Atëherë, Ibn Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i tha: “O djali i vëllait tim, Allahu i Madhëruar, ashtu siç u vendosi syve tanë një cak të cilin nuk munden ta tejkalojnë, ashtu u ka vendosur edhe syve të zemrave tona (mendjeve) një cak të cilin s’munden ta tejkalojnë dhe një kufi të cilin s’munden ta kapërcejnë.”

Tha: “Djaloshi, pasi dëgjoi këto fjalë, u kthjellua dhe hoqi dorë nga të pyeturit për ato gjëra të cilat s’bëjnë dobi, si dhe prej të menduarit rreth atyre çështjeve të cilat e shastisin mendjen dhe zemrën.”⁹

Edhe shqisat gjithashtu janë të kufizuara. Jo çdo gjë që ekziston, mund të perceptohet nga shqisat tona.

Të gjithë janë të një mendjeje rreth faktit se ato gjëra të cilat i perceptojnë shqisat ekzistojnë, mirëpo mbi ç’bazë na u dashka të pohojmë se çfarë nuk perceptohet me anë të shqisave nuk ekziston?!

Shqisat tona janë shumë të dobëta dhe të paaftha për të qenë kriteri përcaktues i ekzistencës apo mosekzistencës së gjërave. Argument për këtë është fakti se shqisat, ndonjëherë mund të jenë të pasakta në përcjelljen e realitetit të gjërave tek ne. Pra, ato mund të na e paraqesin diçka, ndryshe nga çfarë ajo është në të vërtetë. I tillë është shembulli i mirazhit.

Nganjëherë verës, nën diellin përvëlues, a nuk të duket sikur mbi rrugë shikon një pellg me ujë, dhe kur afroresh shikon se aty s’ka asnjë pikë ujë, por ai ka qenë thjesht një mirazh?

⁹ “El Ibaneh” i autorit Ibën Batah, vëllimi: 1, faqja: 422.

Kështu pra, edhe syri i cili është shqisa më e mprehtë, mund ta tregojë diçka ndryshe nga çfarë ajo është në realitet. Të njëjtën gjë e vërejmë nëse vendosim një laps brenda një gote të mbushur me ujë. Lapsi do të na duket sikur është i thyer, edhe pse ne e dimë se ai nuk është i thyer.

Pra, është mëse e qartë se për ta njohur realitetin e gjërave, nuk mjafton të bazohemi kryekëput vetëm te shqisat, ashtu siç pretendojnë ateistët. Kjo çështje është e qartë, edhe pse ata vazhdojnë të gënjejnë vetveten.

Njeriu i mençur e di mirë se nuk është e mundur që duke u bazuar vetëm në mendjen (logjikën) dhe shqisat, të jemi në gjendje të njohim realitetin e gjithçkaje, apo të jemi të aftë të shpjegojmë çdo mister. Është e pamundur për mendjet dhe shqisat tona të japin një vendim të saktë e të pakontestueshëm për çdo gjë.

Shembulli më i mirë për këtë është shpirti, i cili është gjëja më pranë njeriut, madje është vetë njeriu. Realitetin e shpirtit, mendja dhe shqisat nuk mundën ta shpjegojnë apo ta përshkruajnë. Madje më i çuditshëm se kaq është fakti se mendja, nuk është e aftë të shpjegojë se çfarë është vetë ajo, pra mendja nuk di ta përshkruajë vetë mendjen. Të njëjtën gjë themi edhe për realitetin e ëndërrave dhe vegimeve, e po ashtu themi edhe për realitetin e forcës së rëndësës etj. Asnjë ateist nuk i mohon ato, edhe pse mendja dhe shqisat nuk arrijnë ta perceptojnë tërësisht realitetin e tyre.

Pas kësaj që thamë, na bëhet e qartë se fjala e ateistit: *“Përderisa nuk e shohim Allahun, atëherë Ai nuk ekziston”*, është fjalë e cila e nënçmon dhe e përçmon intelektin dhe rolin e vërtetë të shqisave. Kjo sepse, nëse do ta merrnim për të mirëqenë fjalën e tij gjatë studimit të lëmvive të ndryshme në fushën e shkencës, fushë së cilës ai pretendon se i përket, atëherë do na duhej të hidhnim poshtë të gjitha parimet dhe bazat e shkencave eksperimentale

që janë vendosur deri më sot, pasiqë askush nga shkencëtarët nuk e ka parë ndonjëherë elektronin, e as lëndën e errët e cila presupozohet se mbush hapësirën e universit. Po ashtu, asnjëri prej tyre nuk i ka parë valët e dritës, e as valët elektromagnetike, e natyrisht që shembuj të tillë të cilët kanë të bëjnë me shumë të vërteta shkencore, ka sa të duash.

Pamundësia për ta parë Allahun e Madhëruar (në jetën e kësaj bote) dhe pamundësia jonë për ta përfshirë realitetin e Tij me mendjet tona, kurrësesi nuk do të thotë se Ai nuk ekziston. Mendjes i mjafton të argumentohet për ekzistencën e Tij, duke u bazuar në Atë që Ai ka krijuar, si dhe në përsosmërinë mahnitëse që Ai ka vendosur në atë krijim. Ndërsa njohja e hollësishme e Qënies së Tij, apo e cilësive të Tij, është diçka që nuk mund të arrihet nëpërmjet mendjes dhe meditimit.

Shkencëtarët dhe biologët nuk janë në gjendje të përfshijnë me njohuritë e tyre, gjithçka që ka të bëjë me një mizë, e si tentojnë që po nëpërmjet asaj mendjeje të mangët e të kufizuar, të dinë gjithçka rreth Allahut të Madhëruar?!

Pra, fakti që ne Allahun nuk e shohim, nuk do të thotë se Ai nuk ekziston. Nëse ateisti shikon një njeri i cili që kur ka lindur nuk e ka parë dhe nuk e ka njohur babanë e tij, a do të thoshte ateisti se ai njeri s'ka baba, pasi ai nuk e ka parë atë?!

S'ka dyshim se doktrina ateiste është e brishtë dhe aspak e bazuar shkencërisht, edhe pse ateisti pretendon ndryshe.

Ndër gabimet metodologjike të tyre, që kanë të bëjnë me këtë çështje, është fakti se ata, pasi i kufizojnë perceptueshmëritë vetëm duke u bazuar te shqisat, nuk pranojnë t'i marrin në konsideratë lajmet dhe informatat e sakta, të cilat vijnë nga burime të besueshme, e për vërtetësinë e të cilave ka argumente të pakundërshtueshme. Natyrisht që ky refuzim i tyre është i

papranueshëm, pasi çdo njeri me mend e ka të qartë se njohuritë përftohen nëpërmjet shqisave, përftohen nëpërmjet të logjikuarit dhe të menduarit, por përftohen gjithashtu edhe nëpërmjet lajmeve dhe informatave të sakta.

Është për t'u çuditur në këtë pikë, pasi ata, edhe pse teorikisht i përgënjeshtrojnë ato lajme dhe informata, realisht ata në argumentimet që sjellin, vijnë po me thënie dhe lajme të cilat u kanë ardhur nga burime të ndryshme. Pra, ata i mohojnë dhe i pranojnë ato njëkohësisht.

Kur debaton me ta, do të shohësh se ata argumentojnë me teori të ndryshme. Nëse i pyet: A mos vallë ti e ke nxjerrë vet këtë rezultat dhe ke arritur në këtë përfundim? -do të thotë: -jo, por ky është mendimi i filan shkencëtari të cilin e ka cituar filan autor. Këtu i themi: Ja pra, e kundërshtove parimin tënd të mëhershëm, në të cilin e mohojë informacionin e ardhur nga burime të besueshme, pasi ti tashmë je duke pranuar për të mirëqënë një informacion të cilin nuk e ke përfutur nëpërmjet shqisave të tua, por nëpërmjet informatave dhe njohurive që të kanë ardhur.

Duke u nisur nga sa u tha më sipër, na bëhet e qartë se ateisti s'ka asnjë të drejtë t'ia quajë mendjelehtësi besimtarit faktin se ai i beson dhe i pranon lajmet që kanë të bëjnë me të fshehtën (gajbin)¹⁰. Nëse ateisti do të justifikohet duke thënë se ai i pranon ato lajme, pasi ato tregojnë për çështje të prekshme e të perceptueshme për shqisat, ne i themi: edhe lajmet që kanë ardhur nëpërmjet profetëve tregojnë po ashtu për çështje të prekshme, të cilat një pjesë prej tyre shqisat tona arrijnë t'i perceptojnë që në këtë jetë¹¹ ndërsa një pjesë tjetër do të jetë e perceptueshme

¹⁰ Sh.p.:Të besosh në gajb do të thotë të besosh në çdo gjë të padukshme për të cilën na ka lajmëruar Allahu i Madhëruar apo Pejgamberët e Tij.

¹¹ Sh.p.: Siç janë psh përgjigjia e lutjeve të atyre që luten, vërtetimi i mrekullive Kuranore të përmendura që para 14 shekujsh, vërtetimi i lajmeve profetike për

në Botën tjetër. Pra, nëse ato që ata i pranojnë janë lajme, edhe këto që besimtarët i pranojnë janë po ashtu lajme, madje lajmet e ardhura nga Profetët janë më parësore për të qenë të besueshme e për t'u pranuar, pasi argumentet e pakontestueshme kanë vërtetuar saktësinë dhe besueshmërinë e tyre.

Si përfundim, për sa i përket kësaj çështjeje, themi se: “Doktrina ateiste” është një doktrinë kontradiktore. Ajo e pohon diçka si të vërtetë, ndërkohë që e mohon diçka tjetër e cila është po e së njëjtës natyrë me të. Shembull shumë i qartë në lidhje me këtë është fakti se ata e mohojnë zanafillën e krijimit të Ademit (alejhi selam!) nga balta dhe çdo etapë tjetër të krijimit të tij dhe të shtimit të pasardhësve të tij (njerëzve) dhe kjo për arsyen e vetme se lajmi rreth këtij krijimi është diçka e fshehtë dhe e papercptueshme, ndërkohë që e konsiderojnë si të vërtetë shkencore faktin se origjina e krijimit të specieve e ka zanafillën para miliona vitesh, nga një qelizë e vetme (e cila nuk dihet se si mbiu?!), e që më vonë evoluoi sipas parimeve të “përzgjedhjes natyrore”. Nga ajo presupozohet se doli një qelizë tjetër, e kështu me rradhë u shtuan gjallesat. A nuk e konsideron ateisti të besuarit në një teori të tillë “besim në të fshehtën”?! Cili është ai që e ka parë se me të vërtetë kjo është zanafilla e krijimit të specieve?! Ateisti e merr për të mirëqenë këtë teori, vetëm për faktin se ajo është një teori ateiste, ndërsa lajmin që na ka ardhur nëpërmjet shpalljes kuranore, ata e mohojnë, për arsyen e thjeshtë se ajo ka të bëjë me fenë dhe besimin.

Pra, metodologjia e ndjekur prej ateistëve, është një metodologji kontradiktore, e cila nuk është ngritur mbi baza shkencore, por vetëm mbi kapriçot dhe tekat e tyre.

E DYTA: PARIMI I DYSHIMIT

Dyshimi është ashti dhe mish i ateizmit. Ateisti, nuk është gjë tjetër, veçse një përzjerje e përbërë prej dyshimit dhe paqartësisë së mendimeve. E ndoshta, përkrahimi më i mirë për gjendjen e tij, përmendet në këtë poezi, ku njëri prej tyre thotë:

Erdha, nuk e di se nga, por di që erdha,
Pashë para meje rrugë dhe në të eca,
Dhe do të vazhdoj të eci, desha apo nuk desha,
Si erdha? Si e pashë rrugën time?
Nuk e di!...

Dhe rruga ime, ç'është rruga ime?
A është ajo e gjatë apo e shkurtër?
Në të, jam duke u ngjitur, apo duke zbritur?
Jam unë ai që eci në rrugë,
Apo është rruga që lëviz?
Apo të dy qëndrojmë ngurosur, ndërsa ajo që ecën është koha?
Nuk e di!...

Jam i ri apo i vjetër në këtë ekzistencë?
A jam i lirë dhe i papërmbytur, apo eci i lidhur me zinxhir?
A jam drejtues i fatit tim, apo fati është caktuar?
Do të doja ta dija , por...
Nuk e di!

Po më herët se të bëhesha njeri,
A thua kam qenë gjësend? Apo isha inekzistent?
A ka përgjigje ky mister, apo i tillë do të mbetet përherë?
Nuk e di!...
E përse nuk e di?!
Nuk e di!

Ky parim, pra parimi i dyshimit është strumbullari i ateizmit. Farën e dyshimit ateistët duan ta mbjellin sa më shumë të jetë

e mundur, e sidomos te brezi i ri, duke filluar që në vegjëli. Ata e shohin këtë kategori të shoqërisë si prenë më të lehtë për ta orientuar drejt ateizmit, e këtë e bëjnë duke mbjellë dyshime nëpërmjet mënyrave nga më të ndryshmet, duke filluar që nga bankat shkollore.

Ndër të parët që ka folur rreth këtij parimi, ka qenë Aristoteli, i cili ka thënë: *"Cilido që dëshiron të thellohet në njohuritë hyjnore, duhet që fillimisht të fshijë nga zemra e tij të gjitha njohuritë dhe bindjet që ka e pastaj të dyshojë në gjithçka. Pasi të ketë vepruar në këtë mënyrë, le të mjaftohet me atë që i thotë mendja dhe imagjinata e tij."*¹²

Parimit të dyshimit, ateistët i shtuan edhe një tjetër parim, atë të së vërtetës relative.

Për ata, e vërteta është relative dhe asgjë sipas tyre nuk është e vërtetë absolute. Me parimin e dyshimit dhe me atë të së vërtetës relative, doktrina ateiste është gati për marshim dhe nuk i nevojitet gjë tjetër, përveç disa ithtarëve fanatik, mbajtës të flamurit të ateizmit, të cilët vazhdimisht dhe pa u lodhur i ngasin njerëzit drejt tij¹³.

¹² Sh.p.: Kjo thënie e tij të kujton ajetin kuranor: "A e ke parë ti atë që ka marrë si të adhuruar atë çfarë epshi dhe tekat i kanë sugjeruar? A do t'i bëhesh mbrojtës atij? A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti (kafshë). Madje, ata janë edhe më të humbur (se sa kafshët) nga rruga e drejtë." El Furkan, 44-43.

¹³ Nga shembujt e kësaj kulture e cila promovohet prej tyre, është dhe artikulli i njërit prej tyre me titull: "Le të dyshojmë në mënyrë që të mos biemi pre" e të vërtetave tona", në të cilin ndër të tjera autori thotë: "Njeriu patjetër duhet të dyshojë goftë dhe njëherë të vetme..... Më pas thotë: "Dyshimi lind natyrshëm, veçanërisht duke marrë në konsideratë që e vërteta është relative, si në aspektin shoqëror dhe në atë kulturor. Dyshim ky, i cili e bën njeriun që të mos entuziazmohet për asgjë dhe të mos i skuqet fytyra prej asgjëje dhe të mos mbajë asnjë lloj qëndrimi kritik ndaj askujt i cili i kundërshton parimet dhe vlerat. Kjo sepse dyshimi e bën njeriun që gjatë gjithë kohës të ketë prezente në veten e tij disa pikëpyetje të gatshme, të llojit:

Është për t'u çuditur me faktin se ata edhe pse shprehen se parimi i dyshimit është i rëndësishëm tek ta, përsëri janë vetë ata që së shumti bien ndesh me të. E themi këtë, sepse kur bëhet fjalë për teoritë ateiste, ata nuk lejojnë që të dyshohet në to, por përkundrazi, i mbrojnë ato me fanatizëm dhe i paraqesin si të vërteta absolute. Askush nuk guxon t'i kundërshtojë apo të dyshojë rreth saktësisë së tyre, e natyrisht që kjo është një tjetër kontradiktë e tyre.

Sidoqoftë, ne themi se parimi i dyshimit është i gabuar dhe i papranueshëm logjikisht. E si të mos jetë kështu, kur sipas atij parimi kërkohet që çdo njeri i cili beson në disa të vërteta, duhet t'ia nisë të dyshojë në lidhje me saktësinë e tyre, e vetëm pasi të ketë dyshuar, mund t'i besojë përsëri! Kjo është si t'i thuash dikujt: Ti duhet që fillimisht të pish helmin, në mënyrë që t'i gëzohesh efektit pozitiv të kundërhelmit. Natyrisht që asnjë njeri me mend nuk do ta pranonte një gjë të tillë.

Ndërsa sa i përket teorisë tjetër, sipas së cilës e vërteta është relative dhe se nuk ka të vërteta absolute, themi se gabimi në të është edhe më i qartë dhe i dukshëm, kjo për vetë faktin se do të mjaftonte për ta rrëzuar këtë teori, të argumentuarit me vetë atë, pasi përderisa të gjitha të vërtetat janë relative, atëherë edhe

E pse të mos jetë pikëpamja e tjetrit ajo e sakta?! E pse të mos jetë këndvështrimi i tjetrit -individ apo grup njerëzish apo parti apo sekt- pikëpamja e tij, botëkuptimi i tij, konkluzionet e nxjerra prej tij, etj që përmban në vetvete diçka të saktë?! Në aspektin tjetër: E ku i dihet, ndoshta këndvështrimet e mia nuk janë tërësisht të sakta?!..."

Këtu vërehet qartë se dyshimi –sipas tyre- duhet të përfshijë çdo gjë, duke mos bërë dallim ndërmjet besimtarit dhe jobesimtarit, muslimanit dhe ateistit. Në këtë lloj klime të tejngarkuar me dyshime njeriu s' mund të jetë ndryshe veçse i zhveshur nga qëndrimet parimore dhe morale, sepse tek ai çdo e vërtetë është relative duke mos lënë vend për ndonjë të vërtetë absolute.

kjo teori e së vërtetës relative është gjithashtu relative. Pra, si mund ta konsiderojmë si të mirëqenë një teori e cila dëshmon për vetveten se është relative?! Kështu pra, kjo teori rrëzon vetveten që nga themeli.

E sikur ta konsideronim si të vërtetë e të bazoheshim në këtë teori, atëherë çdo normë dhe ligj do të ishte i pavlefshëm dhe gjithçka do të merrte tatëpjetën, pasi duke u nisur prej kuptimit të saj, dikush fare lehtë mund t'i shkelte të drejtat e tjetrit, apo ta dëmtonte atë. E nëse ti i thua se ai veprim i tij është i gabuar dhe se nuk i lejohet ta cënojë të drejtën e tjetrit, ai do të të thoshte: -Çfarë e shikon ti si të gabuar, unë nuk e shoh ashtu, pasi e vërteta është relative. E nëse atij i thuhet: -Ti e di që nuk të lejohet ta dëmtosh tjetrin! -do të thoshte: -Atë që ju e konsideroni si dëmtim, unë e konsideroj ndryshe.

A nuk do të ishte absurde dhe tepër e çuditshme kjo situatë?! Natyrisht që teoria e së vërtetës relative do të shkaktonte trazira dhe probleme të shumta.

Ndryshe është gjendja tek ne muslimanët, e për këtë falenderimi i përket Allahut! Ne jemi plotësisht të bindur dhe besojmë me besim të palëkundur, si malet, se Allahu i Madhëruar është i Vërtetë, ashtu siç ka dëshmuar për Vetën e Tij në Kuranin Famëlartë:

”Këtë (e themi për ta bërë të qartë) se Allahu është Ai i Vërteti”El Haxh, 6.

E po ashtu i Dërguari i Tij, Muhamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), është i vërtetë. Edhe shpallja të cilën Allahu i Madhëruar ia zbriti të Dërguarit të Tij është e vërtetë absolute, rreth së cilës nuk ka dyshim. Allahu i Madhëruar thotë:

“Ne me urtësi e zbritëm atë (Kur’anin) dhe me urtësi është zbritur. E ty (o Muhamed) nuk të dërguam tjetër vetëm se përgëzues dhe qortues.” El Isra, 105.

Ndërsa në një tjetër ajet, thotë:

“E ata kërkojnë t’u tregosh: A është e vërtetë ajo (që thua)? Thuaj: ‘Po, pasha Zotin tim, ajo është më se e vërtetë.” Junus, 53.

Ajo që ne besojmë është e vërtetë: **“E pas të vërtetës, ç’mund të ketë tjetër, përveçse humbje?”** Junus, 32.

Nga kjo që kemi përmendur deri tani, na bëhet mëse e qartë se ateizmi është kazma më shkatërrimtare e cila po përdoret për rrënimin e shumë të vërtetave shkencore, e po në të njëjtën kohë, është mjeti më efikas për të shkaktuar çoroditje masive dhe për të përhapur paturpësi dhe shthurje morale, duke tentuar të mos lërë asnjë lloj pengese parimore apo morale.

Doktrina ateiste është promovuesja kryesore e degjenerimit dhe kaosit, pasi ajo nuk pranon dhe nuk dëshiron ta njohë Allahun Fuqiptotë, i Cili është Mbikëqyrësi, e tek i Cili çdo njeri do të japë llogari për atë që ka punuar.

Duke mos e pranuar se ka një Zot, i Cili do t’i shpërblejë dhe ndëshkojë njerëzit në varësi të asaj që kanë punuar, rrjedhimisht ateistët mohojnë çdo parim i cili kërkon rregull, vetpërmbajtje dhe disiplinë.

Pikërisht për këtë shkak, kjo doktrinë nuk mundet kurrësi të prodhojë qetësi, lumturi dhe rehati. Për këtë dëshmojnë shumë studime dhe statistika botërore të cilat tregojnë se ka një lidhje varësie ndërmjet ateizmit dhe dukurisë së vetvrasjes, pasi është konfirmuar se atje ku përhapja e ateizmit është më e madhe

edhe numri i vetvrasjeve është më i lartë. Sipas statistikave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, vërehet se numri më i lartë i vetvrasjeve në shkallë botërore, është në shtete si: Japonia, Koreja, Finlanda, Franca, Danimarka dhe Suedia. Siç e sheh, numri më i lartë i vetvrasjeve ndodh pikërisht në ato vende të cilat kanë një teknologji tepër të zhvilluar dhe nuk u mungojnë aspak kushtet e mira të jetesës, mirëpo të vërtetën e ka thënë Allahu i Madhëruar:

“E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë...” Ta Ha, 124.

E mbase nuk është nevoja të shkoj aq larg, pasi ne kishim në mesin tonë, në vendet arabe, profesorin dhe akademikun Ismail Ed’hem, i cili gjithë jetën e tij e harxhoi në shërbim të promovimit të doktrinës ateiste, e si përfundim kreu vetvrasje në Aleksandri duke u hedhur në det, pasi kishte lënë më parë një amanet të cilin ia kishte dërguar kryeprokurorit, e në të cilën shkruante: “Vendosa t’i jap fund jetës, pasi nuk kam më dëshirë të jetoj, madje e urrej jetën. Kërkoj që kufoma ime të digjet!”

Përsëri themi: Të vërtetën e ka thënë Allahu. E fjala e kujt mund të jetë më e vërtetë sesa fjala e Allahut, i Cili thotë:

“Thuaj: “A përveç Allahut të adhurojmë çka nuk na sjell as dobi e as dëm dhe të kthehemi mbrapa (në mosbesim) pasi që Allahu na vuri në rrugë të drejtë? Dhe atëherë të bëhemi sikur ai, të cilin djajtë e kanë rrëmbyer (e kanë hedhur) në tokë dhe e kanë lënë të hutuar që, edhe pse ai ka shokë që e thërrasin në rrugë të drejtë (i thonë): ‘Eja te ne!’ (ai nuk përgjigjet). Thuaj: ‘Udhëzimi i vërtetë është udhëzimi i Allahut, dhe ne jemi të urdhëruar që t’i dorëzohemi Zotit të botëve’.”(El En’am: 71)

E TRETA: BOTËKUPTIMI I NGUSHTË DHE I GABUAR QË ATEISTËT KANË RRETH ÇËSHTJEVE TË KADERIT (VENDIMIT DHE PARACAKTIMIT HYJNOR).

Ky botëkuptim i ngushtë dhe i gabuar i tyre shprehet në dy teori të njohura tek ata: në atë që e quajnë *Teoria e së keqes* dhe në *Teorinë e absurditetit*.

Sa i përket të parës, pra Teorisë së të Keqes, ata shprehen se përderisa në botë ekziston e keqja, përderisa në të ndodhin vrasje, përderisa ka sëmundje, shqetësime e lëndime, atëherë të gjitha këto janë tregues se Zoti Fuqiptotë e i Mëshirshëm nuk ekziston, sepse - sipas pretendimit të tyre - nëse do të ekzistonte, nuk do të lejonte që të gjitha këto të ndodhnin.¹⁴

14 Tregohet se një besimtar kishte shkuar te berberi për të prerë flokët. Gjatë tërë kohës sa qëndroi aty bisedonte me berberin. Biseduan për gjëra dhe tema të ndryshme, ndër to biseduan edhe për Zotin. Berberi tha: "Shiko o njeri, unë nuk besoj se Zoti ekziston, siç thua ti." "Pse thua kështu?", - e pyeti besimtari. "Po kjo është shumë e thjeshtë, vetëm duhet të dalësh në rrugë dhe e kupton se Zoti nuk ekziston. Më thuaj po të ekzistonte Zoti a do të kishte kaq të sëmurë? A do të kishte fëmijë të braktisur? Po të ekzistonte Zoti nuk do të kishte vuajtje dhe dhimbje. Unë nuk mund ta paramendoj Zotin i cili i lejon këto gjëra.", - ia ktheu berberi. Besimtari heshti për një kohë duke u menduar. Donte të replikonte, por nuk po gjente ndonjë metodë të fortë për t'iu përgjigjur berberit. Berberi kreu punën e tij dhe besimtari doli nga rrojtoria. Me të dalë në rrugë e pa një njeri i cili kishte flokë të gjatë, ishte i palarë, i pakrehur dhe dukej shumë keq. Besimtari u kthye sërisht te berberi dhe i tha atij: "E di çfarë? Berberët nuk ekzistojnë!" "Si nuk ekzistojnë?", - pyeti berberi. "Jo!", - këmbënguli besimtari. "Ata nuk ekzistojnë, se po të ekzistonin nuk do të kishte njerëz sikurse ai atje në rrugë!" Berberi tha: "Ah, berberët ekzistojnë vetëm se njerëzit nuk vijnë tek ne." "Ashtu është!", - tha besimtari. "Kjo pra është esenca! Zoti ekziston, mirëpo njerëzit nuk kthehen te Ai, nuk i falen dhe luten Atij dhe për këtë arsye ka plot parregullsi në tokë!" (Shënim i përkthyesit).

Ndërsa në lidhje me teorinë e dytë, të cilën ata e kanë emërtuar teoria e Absurditetit; ata pretendojnë se në univers ndodhin gjëra kontradiktore të cilat nuk përputhen me logjikën, ndaj kjo tregon se universi dhe ç`ka në të është fryt i rastësisë dhe nuk i nënshtrohet asnjë rregulli të vendosur nga Zoti, Krijuesi, Drejtuesi dhe Sistemuesi Fuqiplotë, ashtu siç besojnë besimtarët.

- Të dyja këto teori, vijnë si pasojë e një shkakut të vetëm, dhe ai është injoranca, apo të injoruarit qëllimisht të një parimi themelor dhe tepër të rëndësishëm, njohjes së urtësisë hyjnore e cila gjendet në çdo vepër prej veprave të Allahut të Madhëruar si dhe në gjithçka që Ai ka caktuar. Sa bukur e ka sqaruar këtë çështje dijetari i mirënjohur, shkëlqesia e tij Ibën Tejmija (Allahu e mëshiroftë!), në poemën e tij të famshme “Et Teijeh”, në të cilën ka shpjeguar çështjet që kanë të bëjnë me Kaderin¹⁵ (vendimin dhe paracaktimin hyjnor), ku ndër të tjera thotë:

Zanafilla e lajthitjes së njeriut, të çdo soji
Nis kur caktimin e Zotit si të padrejtë e shikon

Nuk e kupton urtësinë e Zotit i Cili përsosi dhe krijoi
Por bëhet injorant dhe nuk arsyeton

Të gjitha sprovat dhe vështirësitë që ndodhin në jetën e kësaj bote, janë të lidhura ngushtë me parimin e sprovës. Allahu i Madhëruar thotë:

“Ai është i Cili krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju sprovuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Ngadhënyyesi, Mëkatfalësi.” El Mulk, 2.

¹⁵ “Mexhmu’ul fetaua”, vëllimi: 8, faqja: 246.

Kështu pra, Zoti ynë vazhdimisht na sprovon me vështirësi nga më të ndryshmet, në mënyrë që të na pastrojë nga mëkatet, të na edukojë, të na përmirësojë gjendjen, apo të na shpërblejë/ndëshkojë për atë që kemi punuar. Shumë prej njerëzve tregohen të verbër në lidhje me të gjitha këto, ashtu siç tregohen të verbër në lidhje me faktin se asgjë nga ato që Allahu i Madhëruar ka caktuar, nuk është dhe s'mund të jetë e keqe absolute. Ndërsa në Atë që Allahu i Madhëruar vepron apo gjykon, aty s'ka dhe s'mund të ketë vend e keqja, ashtu siç e ka përmendur këtë Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), i cili gjatë lutjes së tij, ka thënë:

“Ndërsa e keqja nuk është tek Ti (nuk vjen prej Teje).”¹⁶

Në gjithçka që Allahu i Madhëruar ka caktuar, e keqja në të është e relative dhe jo absolute. Allahu i Madhëruar, i Cili është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë, kur e cakton diçka e cila edhe mund të jetë e hidhur, nuk e ka caktuar atë veçse për një mirësi dhe dobi e cila ose do të jetë e tillë për vetë personin, ose për dikë apo diçka tjetër, pavarësisht faktit nëse njeriu e kupton, apo nuk arrin ta kuptojë urtësinë e saj.

Si përfundim themi: S'ka dyshim se në çdo gjë që Allahu i Madhëruar ka caktuar, ka urtësi dhe dobi. Argumentet që e përforcojnë këtë bindje janë të shumta. Dijetari i mirënjohur Ibnul Kajimi (Allahu e mëshiroftë!), ka thënë se argumentet të cilat tregojnë për urtësinë e Allahut të Madhëruar në gjithçka që Ai vepron, janë më tepër se dhjetëmijë argumente.¹⁷

¹⁶ E transmeton imam Muslimi me nr 771.

¹⁷ Shiko librin “Shifau el alil” vëllimi: 2, faqja: 573.

E KATËRTA: DISA PRETENDIME ABSURDE DHE TË PAPRANUESHME LOGJIKISHT, TEK TË CILAT BAZOHEN ATEISTËT

Sa herë që besimtari i përmend ateistit ligjin e shkakësisë¹⁸, (pra që çdo gjë ndodh si pasojë e një shkakut, dhe se çdo vepër e ka një veprues, sikurse çdo krijesë e cila ekziston, ka Krijuesin e saj), ai (ateisti) i kundërpërgjigjet me një pretendim absurd dhe të papranueshëm logjikisht duke thënë: “Le të imagjinojmë për një moment se kemi rënë dakord që Allahu është Krijuesi i gjithësisë dhe i gjithçkaje që gjendet në të, kjo sepse çdo krijesë ka nevojë për krijues, mirëpo, duke u nisur po nga ky parim, a mund të më thuash kush e krijoi Allahun? Përse të mos e marrim në konsideratë këtë parim edhe kur flasim për Zotin?”

Kjo pyetje është e papranueshme logjikisht, pasi ateisti fillimisht po e pranon se Allahu është Krijuesi, e si pyet pastaj se kush e krijoi Krijuesin?! Ai e quan atë Krijues dhe krijesë në të njejtën kohë, e kjo s’mund të jetë pasi është kontradiktore. Krijuesi s’mund të jetë i krijuar e as krijesa s’mund të jetë Krijuesi.

Prej dyshimeve të kota dhe pretendimeve absurde që ateistët ngrenë, janë edhe pyetje të kësaj natyre: “A mundet të krijojë Zoti një shkëmb aq të madh sa që të mos jetë në gjendje ta ngrëjë?” Natyrisht që kjo pyetje si dhe të tjera të kësaj natyre bëhen për arsye që ta detyrojnë debatuesin të gabojë në çdo përgjigje që jep. Në rastin konkret, nëse ai thotë: “Nuk mundet ta krijojë”, ata thonë: “Atëherë si mund të jetë Zot kur Ai është i kufizuar në fuqinë dhe aftësinë e Tij krijuese?!” E nëse besimtari thotë: “Po,

¹⁸ Lidhje objektive, e domosdoshme ndërmjet shkakut e pasojës. (Fjalori shqip-shqip).

mundet ta krijojë”, ata thonë: “E si mund të jetë Zot kur Ai nuk është në gjendje ta ngrejë atë?!” Pra, qëllimi i tyre me këtë pyetje, është ta detyrojnë besimtarin të dyshojë në Fuqinë e Allahut të Madhëruar, e për pasojë, të dyshojë në ekzistencën e Tij.

Nëse mediton pak më thellë rreth pyetjes së tyre, do të kuptosh se ajo nuk është më tepër se një idiotësi, si dhe një argument më tepër që vërteton se doktrina ateiste është e brishtë dhe naive.

Pra siç e thamë, kjo pyetje është absurde dhe e papranueshme logjikisht. Ajo kundërshton dhe hedh poshtë vetveten pasi fundi i saj bie ndesh me fillimin e saj. Kjo, sepse Ai i Cili është në gjendje të krijojë një shkëmb nga hiçi, natyrisht që është edhe i aftë e i fuqishëm që ta ngrejë atë nëse dëshiron, e asgjë nuk mund ta pengojë.

Ne besojmë dhe kemi bindje të plotë se Allahu i Madhëruar është i Plotfuqishëm për gjithçka. Ai është në gjendje të krijojë çfarë të dojë, qoftë shkëmb apo diçka tjetër e është në gjendje ta ngrejë atë, nëse dëshiron. Allahu i Madhëruar është i Përsosur në të gjitha cilësitë e Tij, e nëse ateisti e konsideron përsosmërinë si mangësi, atëherë ky është një problem serioz që tregon për keqfunksionim të mendjes dhe logjikës së tij, e cila ka nevojë për kurim.

Prej dyshimeve që ata hedhin, është edhe pretendimi i tyre se në Islam ka gjëra të papranueshme logjikisht, e ndër to veçojnë hadithin në të cilin tregohet se dielli pasi perëndon, shkon dhe bën sexhde nën Arshin¹⁹ (Fronin e Zotit), e kjo sipas tyre – është

¹⁹ Hadithin e transmeton imam Buhariu me nr 4802, prej haditheve të sahabiut të nderuar Ebu Dherrit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Teksti i tij fillon me fjalët e Ebu Dherrit i cili thotë: “Isha në xhami bashkë me të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), ndërkohë që dielli po perëndonte. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) më tha: “O Ebu Dherr, a e

e papranueshme logjikisht.

Muslimani është i bindur se ajo që përmendet në hadith është e vërtetë dhe është prej fjalëve të Profetit fisnik (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), pasi hadithi është transmetuar saktësisht. Prej tekstit të hadithit kuptojmë se dielli, në një moment të caktuar të udhëtimit të tij në hapësirë, si dhe në një vend të caktuar, i përulet në sexhde Allahut të Madhëruar, Krijuesit Fuqiptotë.

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), na ka treguar, ashtu siç gjendet në hadithet e tij, se shtatë qiejt si dhe i gjithë universi bashkë me galaktikat madhështore e yjet e panumërt, ku njëri ndër ata yje është dhe dielli ynë ;gjenden nën Arshin e Allahut, kështu që s'ka asnjë problem logjik që dielli t'i përulet në sexhde Allahut nën Arshin e Tij, pasi dielli gjithsesi, nën Arshin e Tij është. Ndërsa sa i përket mënyrës dhe formës se si dielli i bën sexhde Allahut, këtë nuk e dimë, por kjo s'do të thotë se është e pamundur që kjo gjë të ndodhë.²⁰

Ateistët kujtojnë se duke përmendur këtë hadith, po i vënë muslimanët në pozitë të vështirë, mirëpo kjo s'është aspak e

di se ku po shkon dielli?" – Thashë: "Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri." Tha: "Ai shkon dhe bën sexhde poshtë Arshit, ashtu siç tregohet në Fjalën e Allahut të Madhëruar: "Edhe dielli udhëton për në cakun e tij të përcaktuar. Ai (udhëtim) është përcaktim i Ngadhënjyesit, të Dijshmit. Jasin, 38.

²⁰ Nëse para disa shekujsh dikujt do t'i thuhej se do të vijë një kohë kur njerëzit do të komunikojnë, duke e parë dhe duke e dëgjuar njeri-tjetrin në kohë reale, edhe pse fizikisht do të jenë mijëra kilometra larg, do t'i dukej absurde dhe e papranueshme logjikisht, por ja që sot kjo është bërë gjëja më normale falë zhvillimit të teknologjisë. Fakti që diçka mund të duket si e pakonceptueshme dhe e papranueshme logjikisht, nuk do të thotë me patjetër se s'mund të ndodhë, por ndoshta ti nuk arrin të perceptosh mënyrën se si ajo gjë ndodh. (shënim i përkthyesit)

vërtetë. Madje, nëse do të gjykonim drejtë, në pozitë të vështirë janë ateistët, të cilët në lidhje me diellin, atë krijesë madhështore që Allahu Fuqiptotë e ka krijuar e të cilit i ka caktuar të notojë në hapësirë duke mos devijuar udhën e tij, as sa maja e gishtit, në lidhje me atë yll gjigand, temperatura e të cilit është jashtëzakonisht e lartë, ata thonë se është krijuar vetvetiu nga hiçi! A është kjo fjalë e tyre më e denjë për t'u pranuar logjikisht, apo ajo që Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) na ka treguar në lidhje me diellin, pra, se ai i përulet në sexhde Krijuesit Fuqiptotë?! Allahu i Madhëruar e krijoi diellin dhe i caktoi rrugën që duhet të përshkojë, ashtu siç Ai dëshiroi, si dhe e bëri që në një vend dhe në një moment të caktuar, t'i përulet Atij i nënshtruar, edhe pse ne nuk e ndjejmë dhe nuk e dimë formën dhe mënyrën se si i përulet? Natyrisht që kjo e dyta është më e pranueshme logjikisht, e sidomos kur na ka lajmëruar për të Profeti fisnik (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), i cili nuk flet nga vetja e tij, por ajo që ai tregon është shpallje nga Zoti i gjithësisë.

Si përfundim, themi se kjo metodë që ateistët ndjekin, duke hedhur dyshime dhe duke shtruar pyetje retorike, të fryra në pamje të jashtme, por të varfëra në arsyetim, nuk është një metodë e cila mbështetet në qasje shkencore, por më tepër ato janë mjegullnaja të ngritura prej tyre për të mbuluar dobësinë e doktrinës ateiste në njërin anë, si dhe për të përbaltur Islamin dhe doktrinën e tij në anën tjetër.

Për këtë arsye, ata me këmbëngulje e vazhdojnë ofensivën e tyre të ashpër ndaj Islamit duke u përqendruar sidomos në disa çështje të cilat edhe mes muslimanëve nuk janë unanime, apo përkundrazi, tek shumica e tyre mund të jenë çështje të refuzuara, mirëpo ata qëllimisht e identifikojnë Islamin pikërisht me ato çështje.

Kështu veprojnë kur sjellin si shembuj disa nga pikëpamjet e devijuara të ndonjë sektit i cili pretendon se përfaqëson Islamin, por që në realitet është në kundërshtim të plotë me parimet e Kuranit dhe traditës profetike. Ateistët shpesh herë fokusohen tek ato pikëpamje të tyre të gabuara duke i etiketuar ato si parime islame, ndërkohë që dijetarët muslimanë të të gjitha kohërave i kanë demaskuar dhe i kanë hedhur poshtë ato pikëpamje dhe kanë sqaruar se ato s'kanë asnjë lidhje me Islamin burimor. Të njëjtën gjë bëjnë edhe me pikëpamjet e ndonjë individi të caktuar duke i përgjithësuar ato, ndërkohë që ai individ s'është dhe s'mund të jetë Islami, pasi njeriu, cilido qoftë ai është gabimtar, ndërsa Islami është i plotësuar dhe i përsosur prej Zotit të gjithësisë²¹. Kështu pra, ata përziejnë midis asaj që është islame dhe asaj që nuk është prej tij, përziejnë të saktën me të gabuarën dhe të vërtetën me të kotën.

Ata trumbetojnë me të madhe se Islami dhe shkenca nuk mundet të bashkëjetojnë me njëra-tjetrën. Si dhe fokusohen te prapambetja që i karakterizon sot shumë prej vendeve me popullsi muslimane, duke aluduar se është Islami ai që i ka penguar nga zhvillimi teknologjik dhe jo vetëm.²²

21 Në shumë raste të tjera, ata fokusohen tek disa hadithe shumë të dobëta apo të trilluara, pa i kushtuar aspak rëndësi faktit se dijetarët e hadithit i kanë refuzuar ato thënie dhe se nuk lejohet të konsiderohen prej thënieve profetike. Ata u kundërvihen këtyre haditheve të dobta duke pretenduar se po gjejnë të meta dhe kontradikta në thëniet profetike, ndërkohë që nuk e dinë, apo nuk duan t'ia dinë se të gjitha hadithet duhet të verifikohen më parë nga dijetarët e hadithit, dhe jo çdo hadith i përmendur në libra apo në traditën islame është prej thënieve të Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).(Shënim i përkthyesit)

22 E vërteta është krejt e kundërta me atë që ata thonë. Gjendja e muslimanëve sot është e tillë sepse ata janë larg prej parimeve dhe mësimëve të fesë së tyre. Kur muslimanët ishin muslimanë të vërtetë, muslimanë me punë dhe me zemër dhe jo vetëm muslimanë me emër siç janë sot, gjendja e tyre ishte ndryshe. A nuk ishin

S'ka dyshim se kjo mënyrë e vlerësimit nuk është aspak e drejtë dhe e justifikuar, pasi drejtësia e kërkon që Islami të vlerësohet prej parimeve të tij dhe për atë çfarë është në vetvete dhe jo duke u nisur nga sjelljet dhe veprimet e njerëzve të cilët janë, apo pretendojnëse janë ithtarë të tij. E nëse duhet patjetër ta vlerësojnë fenë islame nëpërmjet pasuesve dhe ithtarëve të tij, atëherë le të merren si shembull ata të cilët e kuptuan dhe zbatuan drejtë atë, siç ishte brezi i parë të këtij umeti, brezi i shokëve të Profetit si dhe i atyre që i pasuan ata duke ecur gjurmëve të tyre. Ata jo vetëm që jetuan krenarë në tokë, por me vlerat që rrezatuan, drejtësinë e tyre, me modestinë dhe zellshmërinë e tyre, mbetën shembulli më i mirë për të gjitha gjeneratat që erdhën dhe do të vijnë pas tyre.

muslimanët ata që vendosën bazat e matematikës, algjebërës, kimisë, inxhinierisë, mjeksisë etj?! A nuk ishin muslimanët ndriçuesit e mesjetës së errët, e asaj errësire të kobshme që kishte pllakosur Evropën e atëhershme (të krishterë)? A nuk ishte Andaluzia islame (Spanja) e mbushur me pallate përrallore, shkolla e biblioteka, me rrugë e oborre të shtruara me kalldrëm, e lulëzuar nga kopshtet me lule dhe e zbukuruar me shatërvanët magjepsës?! Për të mos harruar Perandorinë Osmane, e cila ishte një superfuqi shumëshekullore, brenda së cilës, muslimanët, hebrenjtë dhe të krishterët jetonin në paqe dhe harmoni me njeri-tjetrin? Nuk është Islami ai që na ka lënë të prapambetur, por jemi ne që kemi braktisur mësimet islame, prandaj gjendja e shumë prej muslimanëve sot është e mjeruar.(shënim i përkthyesit).

KAPITULLI I TRETË

MËNYRAT SE SI PROMOVOHET ATEIZMI

Realiteti dëshmon se ateistët janë tepër aktivë në promovimin dhe përhapjen e doktrinës së tyre, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë vendeve ku shumica e popullsisë është muslimane, e këtë e bëjnë për disa shkaqe:

1. Sepse ateistët në vendet islame ndihen të izoluar, kështu që përpiqen sa të jetë e mundur ta zgjerojnë rrethin në mënyrë që të dalin nga guaska e tyre dhe të “çlirohen” disi nga izolimi, e kjo i nxit ata që t’i shtojnë përpjekjet për promovimin dhe përhapjen e doktrinës ateiste. Kështu veprojnë të gjithë ata të cilët kanë rënë viktimë e së keqes, ata dëshirojnë që të gjithë njerëzit të bëhen si ata, në mënyrë që të mos ketë kush t’i kritikojë, apo që kritikuesit të mbeten të izoluar dhe jo ata²³. Tregohet se Uthman ibën Afani (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), ka thënë: *“Imoralet do të dëshironin që të gjitha gratë të ishin si ato.”*

²³ Sh.p.: Shembull tjetër aktual janë metodat ofensive të promovimit të homoseksualizmit.

Duke u shtuar numri i ateistëve, e sidomos në mesin e akademikëve dhe intelektualëve, ata bëhen faktor i rëndësishëm në jetën shoqërore të vendit ku jetojnë, e kështu rritet influenca dhe ndikimi i tyre dhe rrënjosen themelet e doktrinës së tyre.

2. Duke qenë se shumica e ateistëve janë të prirur drejt përfitimeve materiale (ateizmit utilitar) dhe pragmatizmit, ata synojnë liberalizmin dhe shfrenimin total. E natyrisht që përhapja në masë e ideologjisë ateiste, e cila hedh poshtë të gjitha vlerat morale që predikon besimi, me siguri që do t’ju vinte për shtat, e sidomos në vendet islame, të cilat njihen për konservatorizmin e tyre fetar.

3. Dëshira që ka ateisti për ta qetësuar ndërgjegjen e tij, pasi siç e kemi përmendur edhe më herët, ateisti ka një personalitet të paqëndrueshëm dhe është i prirur të dyshojë për gjithçka, mirëpo duke u shtuar numri i ateistëve, vetja e tij qetësohet disi dhe kjo e bën më të qëndrueshëm në bindjet e tij.

Pasi përmendëm disa nga shkaqet që i motivojnë ateistët për ta përhapur sa më shumë ideologjinë e tyre, në vijim do të përmendim shkurtimisht mënyrat dhe mjetet me të cilat ata përpiqen t’i bëjnë për vete të rinjtë dhe të rejat muslimanë, ku ndër to veçojmë: **librat me përmbajtje ateiste**, të cilat shiten apo shpërndahen falas, e sidomos nëpërmjet internetit, pasi ateistët jo gjithnjë ftojnë në mënyrë direkte në ideologjinë e tyre, por përpiqen të përhapin “kulturën” e dyshimit apo qasje të cilat synojnë të dobësojnë bindjen dhe besimin karshi teksteve fetare, si dhe ta paraqesin fenë si diçka të urryer në sytë e lexuesit duke e pasqyruar në trajtë “prangosëse” dhe “robëruese”. Nëpërmjet këtyre formave, ateistët synojnë që ta orientojnë “prenë” e tyre në batakun e ateizmit.

Ateistët përpiqen që t'i arrijnë synimet e tyre nëpërmjet disa hallkave të njëpasnjëshme.

Njëra nga ato hallka është edhe promovimi i ideologjive ateiste, nëpërmjet kanaleve televizive satelitore.

Ndonjëherë kjo bëhet haptazi, e ndonjëherë tjetër në formë të kamufluar. Përmbajtja e programeve të atyre kanaleve, ditë-natë fokusohet në këtë drejtim, nëpërmjet shfaqjes së filmave artistik, për të rritur dhe fëmijë, si dhe nëpërmjet debateve rreth tematikës së ateizmit që zhvillohen në studio.

Po ashtu, pjesë e atyre programeve mund të jenë edhe filmat dokumentarë me karakter shkencor, që promovojnë teoritë tek të cilat bazohet ideologjia ateiste, siç është teoria e Darvinit. Disa prej kanaleve satelitore më të njohura, janë të fokusuara pikërisht në këtë drejtim.

Po ashtu, prej metodave të tyre janë edhe **takimet direkte me të rinjtë**, qoftë kjo në mënyrë individuale, apo në takime publike të cilat shpesh herë prezantohen si simpoziume kulturore, mirëpo që kanë si synim promovimin e ateizmit.

Përveç këtyre që kemi përmendur, vlen të veçojmë edhe dy mjete të cilat, sipas mendimit tim, janë edhe më efikase në deformimin e botëkuptimit të të rinjëve musliman:

E para: Npërmjet internetit, i cili me përhapjen e tij të jashtëzakonshme, përveç aspekteve pozitive, ka edhe anët e tij të errëta si dhe shkakton dëme të shumta. Mënyrat e shumta të komunikimit elektronik, bëjnë të mundur shkëmbimin e ideve dhe ideologjive të ndryshmet, nga njëri skaj i globit në tjetrin pa asnjë lloj kontrolli apo mbikëqyrjeje.

Shfrytëzimi i internetit prej ateistëve realizohet në shumë mënyra:

1. Njëpërmjet faqeve të rrjeteve sociale siç janë twitter dhe facebook.

Ndikimi kulturor që këto rrjete sociale kanë në shoqëritë e sotme është i hatashëm. Shumë prej të rinjve, çdo ditë kalojnë orë të tëra para kompjuterit duke qenë në gjendje të njihen me çdo lloj filozofie dhe ideologjie, si dhe duke i patur mundësitë të kontaktojnë virtualisht pothuajse me çdokënd. Ateistët, ashtu si mbartësit e çdo ideologjie tjetër, përpiqen që parimet dhe filozofitë e tyre t'i proklamojnë sa më shumë të jetë e mundur, e sidomos duke i kushtuar një rëndësi të veçantë vendeve islame, pasi ndikimi i tyre i prekshëm fizikisht në ato vende ka qenë tepër i limituar. Metodat që ata ndjekin janë të larmishme; ndonjëherë të drejtpërdrejta, e ndonjëherë në mënyrë indirekte, duke i prezantuar idetë dhe parimet ateiste me ambalazhim tërheqës. Prej mënyrave indirekte mund të jetë për shembull ngritja në piedestal e filozofëve dhe figurave të shquara ateiste, apo e veprave të tyre filozofike dhe jo vetëm. Në të njëjtën linjë janë edhe dyshimet, në dukje naive, që ata hedhin në lidhje me vlerat dhe parimet fetare, apo duke ironizuar e përçmuar dispozitat dhe ligjet e fesë, e jo rrallë herë duke i fyer e duke u tallur me hoxhallarët dhe krerët fetarë në përgjithësi.

Një mënyrë tjetër është hedhja e sloganeve të cilat në pamje të jashtme duken progresive, por që njëpërmjet tyre synohet që të përgatitet terreni i përshtatshëm për promovimin e ateizmit. Të tilla janë sloganet të cilat nxisin për të qenë dyshues dhe “mendje-hapur” ndaj gjithçkaje dhe për shprangosjen e mendjes prej “vargonjëve të hekurt” të çfarëdolloj idealizmi, e sidomos atij fetar. Të tjera slogane janë edhe ato që synojnë shfrenim total

të moralit, pa iu përmbajtur asnjë norme shoqërore apo fetare. Përmbajtjet e tyre, direkt apo indirekt i zhvlerësojnë e i hedhin poshtë të gjitha parimet morale të cilat bazën e kanë te feja dhe nxisin për rebelim ndaj të gjitha ligjeve, normave dhe mësimëve fetare si dhe për rebelim ndaj vetë fesë në tërësi.

2. Njëpërmjet faqeve të internetit të cilat janë të formatuara posaçërisht për publikimin e materialeve video, ku më e famshmeja prej tyre është kanali youtube, i cili ndoshta është kanali që gëzon më tepër popullaritet në rrjet.

Ateistët natë e ditë pa pushim publikojnë në youtube video të cilat promovojnë ideologjinë e tyre. Shpesh herë videove u vendosin tituj tërheqës për të rinjtë e që e fshehin përmbajtjen reale të videos. Për shembull i vendosin si titull ndonjë emër futbollisti të famshëm, apo ndonjë fjalë e cila përdoret shpesh nga të rinjtë, siç është fjala “Derbi” apo fjala “Gol”, apo emri i ndonjë aktori, i ndonjë këngëtareje apo i ndonjë personazhi të famshëm të botës së spektaklit. Kur e hap videon, do të shohësh se përmbajtja e saj s’ka asnjë lidhje me titullin, por gjen se ajo tregon për teoritë e Darvinit, apo për filozofitë ateiste. E gjithë kjo bëhet në mënyrë që i riu apo e reja muslimane të bjerë në kontakt në mënyrë të pavullnetshme me idetë dhe parimet ateiste, e ndoshta ato zënë vend në zemrën dhe mendjen e tij, apo më së paku në nënvetëdijen e tij.

3. Njëpërmjet forumeve të përgjithshme.

Ateistët i hedhin “rrjetat” e tyre në forumet online e sidomos në ato forume ku numri i anëtarëve pjesmarrës është i lartë. Në këtë mënyrë ata synojnë që me një gur të vrasin dy zogj: të hedhin dyshimet e tyre, si dhe të përzgjedhin anëtarë dhe bashkëpunëtorë të rinj, të cilët ndajnë të njëjtat ide me ta. Kështu pra, nëse ata

gjejnë se dikush prej anëtarëve, qofshin djem apo vajza, tregon interes në lidhje me postimet e tyre, ata kërkojnë ta zhvillojnë edhe më tej ndërveprimin me ta, e këtë e bejnë në shumë mënyra, si për shembull: duke lavdëruar çdo postim të atyre anëtarëve si dhe duke i kontaktuar privatisht ata, qoftë nëpërmjet e-mailit, por edhe nëpërmjet bashkëbisedimit direkt online. Kështu i forcojnë marrëdhëniet e tyre me ata të rinj, duke u dërguar materiale dhe libra, të cilat mund të mos jenë thirrje e drejtëpërdrejtë për tu bërë ateist, por që rrahin në ato ujëra, derisa të jetë një “pre” e lehtë në duart e tyre.

4. Nëpërmjet blogjeve²⁴ të posaçme për ateistët.

Kjo ndoshta është mënyra më efikase që ata përdorin në realizimin e synimeve të tyre. Ato blogje mund të jenë rreziku më i madh për të rinjtë musliman, e pikërisht për këtë arsye mendoj se meritojnë vëmendje dhe kujdes të veçantë. Përmes një vështrimi përciptazi, kam gjetur një numër shumë të madh të këtyre blogjeve të cilat promovojnë ateizmin, e të cilave u bëhet publicitet nëpërmjet të gjitha mjeteve që kemi përmendur deri tani.

Duke u nisur nga ajo që kam parë në ato blogje, prej tematikave që ato përmbajnë dhe dyshimeve tepër të sofistikuara që gjenden në to, mund ta them me bindje të plotë, se i riu musliman apo e reja muslimane, pasi të kenë rënë në kontakt me to, nuk kanë për të dalë më me ato mend që kanë hyrë në to, e sidomos nëse pjekuria e tyre fetare është e pa formuar mirë, dhe për fat të keq, e tillë është gjëndja e shumica e të rinjve tanë, e s’ka dyshim se i ruajtur është ai të cilin e ruan Allahu.

Mënyrat që ata përdorin janë tepër të larmishme. Dyshimet që

²⁴ Sh.p.: Ueb ditari blog apo blloku është lokacion në internet në formë të gazetës elektronike apo ditarit, i përbërë prej përmbajtjeve që paraqiten në radhitje të kundërt kohore: tekstet më të reja janë të paraqitura në maje.

ata hedhin janë të mirë-formatuara, saqë vështirë të kalojnë pa lënë gjurmë. Herë fokusohen në anën emocionale të njeriut e herë të tjera i kushtojnë rëndësi manipulimit të mendjes dhe logjikës duke i paraqitur idetë e gabuara si mendime filozofike të sakta. Të vërtetat i paraqesin si të jenë gënjeshtra ndërsa gënjeshttrat si të ishin të vërteta absolute. Shpesh herë i gjen të tallen me parimet fetare duke përdorur sarkazmën dhe ironinë. Ndonjëherë pikëpamjet e tyre i gjen të shprehura në poezi dhe prozë apo nëpërmjet tregimeve dhe romaneve të ndryshme, të cilat në mënyrë indirekte promovojnë ateizmin.

Pra, siç e sheh, është një zinxhir i gjatë i përbërë nga shumë hallka, ku secila hallkë ka rolin dhe rëndësinë e saj në manipulimin e masës dhe përhapjen e ateizmit.

E dyta: Nëpërmjet romaneve dhe tregimeve. E këtu janë për qëllim romanet dhe tregimet të cilat bien ndesh me besimin e pastër monoteist, dhe që shërbejnë si barka të cilat pareshtur, i çojnë njerëzit drejt ateizmit. Natyrisht që romanet janë të fokusuara në perspektivën emocionale, kështu që ato ndikojnë fuqishëm në botëkuptimin e lexuesve të tyre, pasi njeriu është i prirur që t'i pëlqejë tregimet, qofshin ato edhe imagjinare, e sidomos kur trajtojnë tema të cilat kanë të bëjnë me dashurinë dhe ndjenjat. Kështu pra, romanet dhe librat me tregime mund të kenë një ndikim tepër të madh në manipulimin e rinisë sonë, ku të predispozuar ndaj rrezikut, janë më së shumti ata të cilët nuk kanë formimin dhe pjekurinë e duhur fetare, dhe që e kalojnë një pjesë të mirë të kohës duke i lexuar ato.

Këto romane, të cilat janë kurthe të ateistëve, kryesisht prekin çështje të besimit siç janë tematikat që kanë të bëjnë me caktimin

(kaderin), aludojnë në mungesën e urtësisë në atë që Allahu ka caktuar, apo në atë që ata e quajnë “teoria e së keqes” duke dashur me anë të saj të tregojnë se Zoti i Gjithëfuqishëm e i Mëshirshëm, i Cili i drejton dhe i sistemon të gjitha çështjet, nuk ekziston.

Dikush mund të thotë: “Romanet dhe tregimet janë vetëm pjellë e imagjinatës se autorit dhe se ato në realitet nuk pasqyrojnë bindjet e autorit.” Përgjigjja ndaj tij do të ishte se pretendimi i tij është i gabuar. E vërteta është se romani është një mesazh të cilin autori e përcjell në formë tregimi. Në lidhje me këtë, njëri ndër autorët më në zë të ditëve të sotme në botën arabe, shkrimtari Nexhib Mahfudh thotë: *“Shkrimtarët dhe poetët, i përzgjedhin personazhet e tyre, të përshtatshëm për të shprehur çfarë ata kanë në thellësinë e shpirtit të tyre. Nëse personazhi i tij rrezaton optimizëm, atëherë dije se në të vërtetë, ai është optimizmi i autorit të veprës, e nëse personazhi ka karakter rebel, kjo ndodh sepse autori ka dashur të shprehë rebelimin e tij në lidhje me diçka të cilën ai e ka mbajtur të ndrydhur për shumë kohë...”*²⁵

Ashtu siç e kemi përmendur edhe më herët, romanet dhe tregimet jo domosdoshmërisht ftojnë në mënyrë direkte në ideologjinë e ateizmit. Është e vërtetë se shërbimi që ato i bëjnë ideologjisë ateiste ndonjëherë është i drejtëpërdrejtë, por në shumicën e rasteve, ato e manipulojnë lexuesin e tyre ëmbëlsisht, e pa e kuptuar ai shkon i magjepsur e përplaset drejtë e në derën e ateizmit, apo më së paku, ato bëjnë që lexuesi ta shkurtojë largësinë midis tij dhe ateizmit.

Padyshim që kjo është një temë e gjatë dhe me degëzime të shumta, e për ta trajtuar atë ashtu siç duhet nevojitet të tregosh më tepër, mirëpo për të mos u tejzgjatur e për të mos dalë nga formati i këtij libërthi, po mjaftohemi me ato që përmendëm.

²⁵ Vepra letrare e autorit Nexhib Mahfudh, faqja: 56.

KAPITULLI I KATËRT

MËNYRAT DHE MJETET E BALLAFAQIMIT ME IDEOLOGJINË ATEISTE

Dikush mund të thotë: “Ateistët në mesin e shoqërive islame janë të pakët në numër, e influenca e tyre në shoqërinë tonë është e papërfillshme. Përse vallë na u dashka t’u kushtojmë kaq shumë vëmendje?! A s’do të ishte më mirë të mos e hapnim fare këtë temë?”

Përgjigja është që atij t’i thuhet: “E çfarë të bën ty që të mendosh se numri i ateistëve në vendet islame është i vogël e i papërfillshëm?! Si dole me këtë përfundim?! Përkundrazi, ka të ngjarë që situata të jetë shumë ndryshe nga ajo që ne përfytyrojmë. Por, edhe sikur të jetë i saktë supozimi se numri i tyre në vendet tona është i vogël, a do të ishte prej urtësisë që ne t’i injorojmë ata e të mos flasim asgjë rreth ideologjisë së tyre?!”

Le të supozojmë se në një vend të caktuar, shfaqet një sëmundje e rëndë e vdekjeprurëse e cila rrezikon të përhapet mes njerëzve

e të bëjë kërدينë, a do të ishte prej urtësisë që të mos flitej rreth saj, e kjo për arsye se numri i regjistruar i të prekurve nga ajo sëmundje është i vogël?!

A do të ishte e pranueshme logjikisht një gjë e tillë?

Natyrisht që të heshtësh ndaj atij rreziku është e papranueshme, madje përkundrazi, logjika dhe urtësia kërkojnë që njerëzve t'ua bëjmë të qartë rrezikun që i kanoset nga ajo sëmundje, si dhe mënyrën dhe mjetet se si ajo përhapet mes njerëzve, e po ashtu edhe mënyrën se si ata të ruhen prej saj. Kështu pra, nëse obligohemi të jemi shumë të kujdeshëm prej sëmundjeve të cilat na rrezikojnë shëndetin dhe jetën, si do të ishte puna kur bëhet fjalë për një sëmundje edhe më të rrezikshme e ajo është sëmundja e mohimit të Krijuesit Fuqiplotë, si dhe të mos besuarit në librat dhe profetët që Ai dërgoi?!

Vlen të theksojmë këtu, se edhe sikur të supozojmë se një shoqëri e caktuar ka shpëtuar prej kësaj sëmundjeje, shumë shoqëri të tjera nuk kanë shpëtuar aspak, madje vuajnë e lëngojnë prej saj. Pra, të folurit rreth kësaj çështjeje është mëse i domosdoshëm, ashtu siç ishte edhe në rastin e sëmundjes. E s'ka dyshim se kurimi më i mirë është parandalimi, e i mençur është ai njeri i cili merr mësim nga ajo që të tjerët e kanë pësuar.

Mënyrat dhe format për t'iu kundërvënë ateizmit janë të shumta, mirëpo para se të zgjerohemi në këtë temë, dua të theksoj një çështje e cila është tepër e rëndësishme e ajo është vëmendja që duhet treguar ndaj një kategorie e cila duket se është më e predispozuar për të rënë pre e ateizmit. E kam fjalën për të rinjtë muslimanë. Ata ndoshta s'do të ishin kaq të rrezikuar prej kësaj ideologjie nëse nuk do të ishte keqfunksionimi i disa hallkave tepër të rëndësishme edukative siç është roli i arsimit,

roli i shkollave, universiteteve, mediave, roli që duhet të kenë institucionet fetare, e pa harruar rolin tepër të rëndësishëm të edukimit familjar. Nëse hoxhallarët dhe promovuesit e vlerave fetare, bashkë me institucionet e sipërpërmendura do ta ndjenin rrezikun në kohë, atëherë me siguri që ata do mobilizoheshin ashtu siç duhet për t'i bërë ballë këtij vërshimi të ideologjisë ateiste. Allahu i Madhëruar na ka treguar, se sado e madhe që të jetë intriga e jobesimtarëve, ajo përsëri ka për të dështuar, pasi është Ai që e bën atë të dështojë:

“S’ka dyshim se Allahu i shkatërron kurthet e jobesimtarëve.”

Enfal 18

Sipas mendimit tim, masat që duhen ndërmarrë për ballafaqimin me ideologjinë ateiste, duhet të jenë dy llojesh: *Masa parandaluese* dhe *masa kurative*.

Sa i përket masave parandaluese, me to kam për qëllim që të ndërmerren të gjitha shkaqet të cilat do ta pengonin rininë tonë nga rënia në rrjetën e ateizmit. Prej këtyre shkaqeve, veçojmë:

E para: T’i kushtohet një vëmendje më e madhe Librit të Allahut (Kurani) dhe traditës profetike (Sunetit), duke i lexuar ato me vëmendje e meditim. Allahu i Madhëruar thotë: “E si mund të mos besoni, kur juve u lexohen Shpalljet (ajetet) e All-llahut dhe midis jush gjendet i Dërguari i Tij? E kush i përmbahet fesë së All-llahut, ai pa dyshim është i udhëzuar në rrugën e drejtë”{ Ali Imran 101}.

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), ka thënë: “Kam lënë tek ju, atë çfarë nëse kapeni fortë pas tij do t’ju mjaftojë juve për të mos humbur kurrë: Librin e Allahut”²⁶

²⁶ E transmeton Muslimi me numër 1218, nga sahabiu i nderuar Xhabir ibën Abdilah. Ndërsa Ed Deraktuni e transmeton nga Ebu Hurejra, me tekstin: “Po lë tek ju dy gjëra, me të cilat s’do humbisni kurrë; Librin e Allahut dhe Sunetin tim.

E dyta: Përpjekja e vazhdueshme për të ripërtëritur besimin dhe për të shijuar ëmbëlsinë e tij. Kjo bëhet nëpërmjet meditimit rreth cilësive madhështore e absolute të Allahut Fuqplotë, e poashtu nëpërmjet studimit dhe meditimit rreth historisë dhe biografisë së Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), si edhe rreth ngjarjeve që ai dhe shokët e tij finsikë përjetuan. Po ashtu, arrihet edhe duke medituuar thellë rreth parimeve dhe mësimëve të fesë islame. Në hadithin të cilin e transmeton imam Muslimi²⁷, gjejmë se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Do ta shijojë ëmbëlsinë e besimit, cilido që është i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin të Dërguar.”

E treta: Kultivimi i besimit të drejtë në zemrat e njerëzve. E kjo mund të arrihet nëpërmjet mënyrave të shumta, siç janë leksionet dhe mësimet fetare, ligjëratat e ditës së premte në foltoret (tribunat) e xhamive, e po ashtu edhe nëpërmjet programeve televizive apo çfarëdo lloj aktiviteti tjetër i cili do t’i shërbente këtij qëllimi. Një vëmendje të veçantë në këtë kontekst, i duhet kushtuar shpjegimit të bazave të besimit, të cilat, me sukses nga Zoti, bëhen shkak për neutralizimin total të ideologjisë ateiste. Këtu mund të theksojmë: Besimin në të fshehtën (gajbin), besimin në paracaktimin hyjnor (kadanë dhe kaderin), besimi dhe bindja e paluhatshme në urtësinë absolute të Allahut në çdo gjë që Ai ka caktuar të ndodhi apo të mos ndodhi. Madhërimin dhe respektimin e teksteve fetare, si dhe sqarimi dhe qartësimi i çështjeve të besimit dhe kufrit (mohimit), si edhe rrezikun që

Nëse do t’ju përmbaheni atyre të dyjave, s’keni për t’u përçarë mes veti, deri sa të vini te kroi (haudi) im.”

²⁷ Me numër 57, prej haditheve të transmetuara nga El Abas bin Abdul Mutalib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

i kanoset njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër prej këtij të fundit; pa lënë mënjanë sqarimin e relatës që ka logjika me fenë, si dhe faktin se feja e vërtetë dhe mendja e logjika e shëndoshë nuk mundën kurrë ta kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Një tjetër faktor vendimtar është edhe të punuarit për rikthimin e dinjitetit dhe pozitës së nderuar që duhet të ketë mësimi i fesë nëpër shkolla dhe universitete, pozitë e cila për fat të keq është e cunuar. Duhet që sistemi arsimor në vendet tona islame, të hartojë një strategji më efektive për ta mundur një gjë të tillë, ashtu që çdo nxënës musliman, çdo i ri dhe e re, të ketë bindjen e paluhatshme se studimi i fesë dhe besimit është padiskutim, lënda më fisnike dhe më e nderuar, e cila garanton lumturi dhe stabilitet në këtë botë, por edhe shpëtim dhe lumturi pafund në botën tjetër, e si e tillë, degëve të mësim-besimit duhet t'u lihen në dispozicion hapësirat e nevojshme dhe jo të ndodhë e kundërta e kësaj, duke i kushtuar më tepër vëmendje dhe hapësirë degëve dhe specializimeve të tjera në kurriz të degës së mësim-besimit.

E katërta: Forcimi i ndjesisë së besimit, si dhe të krenuarit me faktin se ne jemi musliman, e kjo falë mëshirës dhe mirësisë së Allahut, i Cili na ka nderuar me besim. Ne kemi bindje të plotë se Allahu i Madhëruar është me besimtarët. Ai përkujdeset për ta, i mbron, i ndihmon dhe u jep sukses atyre; ndërsa në botën tjetër, Ai do t'i bëjë ata banorë të xheneteve të begatshme, në të cilat ka lumenj të pashtershëm e kopshte të lulëzuara, e se kulmi i kënaqësisë në të është se do të shohin Zotin e tyre të Gjithëmëshirshëm.

E pesta: “Orientimi kulturor”. Duhet treguar kujdes në lidhje me atë se çfarë prirjesh po kultivohen te të rinjtë tanë. Librat që ata lexojnë, faqet e internetit që frekuentojnë, programet televizive që

ata ndjekin si dhe filmat e dokumentaret që shohin, të gjitha këto kanë nevojë për kujdes dhe vëmendje nga ana e institucioneve dhe organeve përgjegjëse, ashtu që ata të jenë të mbrojtur e të ruajtur nga çdo e keqe. Prej rreziqeve më të mëdhaja që i kanosen rinisë sonë është lënia e tyre pa asnjë lloj mbikëqyrjeje dhe kontrolli. Është tepër e rrezikshme që të lihen adoleshentët dhe të rinjtë tanë që të lundrojnë në faqet e internetit pa asnjë lloj kufizimi. Ne s'mund të jemi të qetë në lidhje me rreziqet që i kanosen fëmijëve tanë, nëse komunikimi jonë me ta; pra komunikimi i babait me djalin, i vëllait me vëllanë, i mësuesit me nxënësit; nuk është komunikim i drejtëpërdrejtë, të cilit i mungon afrimiteti dhe besueshmëria. Të gjithë ne duhet të jemi më të hapur me fëmijët tanë, t'i dëgjojmë ata dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë që ata ta kenë më të lehtë të na pyesin për ndonjë dyshim apo paqartësi që mund të hasin në lidhje me çështjet e besimit, apo edhe në lidhje me çështje të tjera, e jo të shkojnë e ta kërkojnë përgjigjen e dilemave të tyre, në zgavrat e "gjarpërinjve" dhe "akrepave".

E gjashta: Vendosja e një metodologjie të mirëpërcaktuar fetarisht, në lidhje me trajtimin e dyshimeve, përgjigjen ndaj tyre dhe neutralizimin e tyre.

Kjo është një çështje parimore e cila duhet ngulitur mirë në mendjet e brezit të ri. E kam fjalën për faktin se dyshimi është sëmundje, dhe si e tillë duhet trajtuar. Pra, nuk duhet t'i ekspozohesh asaj sa të jetë e mundur, pasi siç kanë thënë të parët tanë të mirë: shëndeti është mirësi e madhe e cila s'ka të krahasuar, e s'ka dyshim se parandalimi i sëmundjes është shumë më mirë sesa kurimi i saj.

Dyshimet janë provë. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) na ka tërhequr vërejtje se kush i shkon

pas sprovës edhe sprovë ka për t'i shkuar pas atij²⁸. Duke u nisur nga çka thamë më sipër, duhet t'i bëhet e qartë brezit të ri, e jo vetëm atyre; që të mos i dëgjojnë ata që përhapin dyshime. Dyshimi është ndikues, ndërsa zemra është e dobët, kështu që ekspozimi ndaj dyshimeve është një aventurë së cilës nuk i dihet fundi. Sa e sa njerëz u mashtruan me veten e tyre! Kujtuani se kishin fituar imunitet ndaj dyshimeve e sprovave, e se kishin arritur pjekuri në diturinë e tyre, mirëpo pasi hynë në një faqe interneti të caktuar, apo dëgjuan fjalët e dikujt dhe u mbiu në zemër dyshimi, të cilin kurrë më nuk mundën ta largonin, madje ai dyshim mund të ketë qenë shkak për shkatërrimin e tyre. Gjithësesi, nëse dikush ka rënë pre e atyre dyshimeve, edhe pse ai mund të mos e ketë dashur e mund të mos e ketë kërkuar një gjë të tillë, le t'i drejtohet Allahut me lutje të sigurtë që t'ja largojë atë dyshim, si edhe e këshillojmë që të shpejtojë për t'u konsultuar me ata që kanë dituri, prej hoxhallarëve apo këshilluesve. Kjo pra është rruga më e drejtë për t'u ndjekur. Ndërsa rrugët e tjera veç kësaj, nuk janë gjë tjetër veçse mashtrim, edhe pse thirrësit e së kotës, nuk lodhen ditë dhe natë duke bërë thirrje për “emancipim kulturor” të pakushtëzuar apo thirrje të tjera “rrezatuese” në dukje, por shfrenuese në përmbajtje. Qëllimi i tyre me anë të atyre sloganeve, është që të marrin kontrollin e rinisë sonë e ta orientojnë atë ashtu siç ua ka qejfi.

Metodologjia legjislative fetare në lidhje me këtë temë është e qartë, e për këtë falenderojmë Allahun.

Ajo metodologji është:

Të tregohet kujdes ndaj së keqes e t'u tërhiqet vërejtja njerëzve prej bartësve dhe promovuesve të saj.

²⁸ E transmeton Ebu Daudi me numër 4264, prej haditheve të transmetuara nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

Të urdhërohet për të mirë e të ndalohet nga e keqja, ndërsa mendjelehtët t'i pengojmë edhe nga e keqja e vetes së tyre nëse është e nevojshme.

E shtata: Kujdesi që u duhet kushtuar të rinjve muslimanë të cilët studiojnë në vendet jo-islame. Dijetarët dhe hoxhallarët tanë e kanë sqaruar mjaftueshëm këtë çështje, pra të jetuarit e muslimanit në vendet jo-islame, apo dërgimi i të rinjve musliman në vendet joislame për arsye studimi, punësimi, biznesi etj. Ata po ashtu kanë sqaruar se kur është e lejueshme e kur nuk lejohet një gjë e tillë. Edhe në rastet kur lejohet, ata kanë përmendur disa rregulla, të cilat duhen marrë në konsideratë e të zbatohen. Realiteti i sotëm, për fat të keq, nuk është aspak i kënaqshëm në këtë drejtim. Për këtë arsye, i kërkojmë çdokujt i cili xhelozon për fenë e tij, që të mos qëndrojë indiferent duke i lënë të rinjtë dhe adoleshentët tanë të cilët janë shpërngulur në vendet joislame, e të cilëve ju mungon dituria fetare dhe përvoja; që të jenë pre e lehtë për ateistët dhe ideologjinë e tyre shkatërrimtare. E ritheksoj këtë pikë dhe ngre zërin, duke iu drejtuar të gjithë atyre të cilët përkujdesen për këta të rinj, e që ju duan të mirën atyre, qofshin organizata apo individë; t'i kushtoni kësaj çështjeje vëmendjen dhe interesimin e duhur. Vendosi programe të cilat të synojnë mbrojtjen e tyre dhe përgatitjen e nevojshme për t'u ballafaquar me kësajsoj problemesh. Këto programe do ishte mirë të implementoheshin para dërgimit të tyre në ato vende, por edhe kur të kthehen prej tyre. Gjithashtu, organet kompetente pranë ministrisë së fesë (në vendet islame), të cilat kanë për detyrë orientimin e të rinjve dhe përkujdesjen ndaj tyre, e bashkë me to edhe dikasteret kulturore, duhet t'i kthejnë syte tek rinia, e veçanërisht te brezi i ri. Duhet të jenë ato barka e shpëtimit në

këto ujëra të trazuara e të turbullta. Promovuesit e vlerave fetare dhe hoxhallarët po ashtu, të mos mungojnë në asnjë mënyrë nga arena e këshillimit dhe davetit (thirrjes dhe udhëzimit). Të mos i lënë të rinjtë pa përkujdesje, por të punojnë me ta e të mos i nënëvlerësojnë vizitat e herëpashershme ndaj tyre, duke i kordinuar të gjitha këto me forumet rinore, forumet e nxënësve, si dhe me administratën dhe përgjegjësit e atyre forumeve.

Po ashtu, teologët, duhet të të kenë pjesmarrje në forumet e të rinjve të cilët studiojnë jashtë vendit, si dhe të ruajnë lidhje të forta vëllazërore me ta, ku të mos mungojë këshilla e ndërsjelltë mes tyre si dhe shpërndarja e librave apo broshurave, e sidomos ato që kanë të bëjnë me problemet të cilat hasin më së tepërmi të rinjtë tanë jashtë vendit, siç është edhe e keqja e ateizmit, për të cilin po flasim.

E teta: Do t'i kërkoja organeve kompetente zyrtare, të bëjnë ç'është e mundur të parandalojnë të gjitha mjetet të cilat kontribuojnë në përhapjen e ideologjisë ateiste, në mënyrë që të mbrojnë rininë islame prej saj. Natyrisht, që të flasësh rreth masave konkrete që duhen ndërmarrë është një tematikë e gjerë e cila kërkon më tepër studim.

E nënta: Zbatimi i të gjitha porosive profetike në lidhje me këtë temë, e ndoshta më kryesorja prej tyre mund të jetë; përmendja e shpeshtë e Allahut të Madhëruar. E themi këtë, sepse ateizmi, ashtu siç e kemi sqaruar edhe më herët, nuk është një ideologji me baza shkencore, por ai më tepër është cytje, ngacmime dhe dyshime, e ne e dimë mirë se cytjet dhe ngacmimet i provokon djalli (shejtani), ndërsa shejtani zmbrapset me përmendjen e Allahut Fuqiplotë. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), ka thënë: “**Njeriu s'mundet të jetë i**

mbrojtur nga e keqja e shejtanit me asgjë tjetër, përveçse me përmendjen e Allahut.”²⁹

Një tjetër porosi profetike në lidhje me këtë temë, gjendet edhe në hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejra, në të cilin, i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), ka thënë: “Njerëzit do vazhdojnë të pyesin, derisa të thonë: “Nëse të gjitha krijesat i ka krijuar Allahu, po Allahun kush e krijoi?” Nëse dikujt prej jush i vjen ndërmend kjo pyetje, le të thotë: “Unë i kam besuar Allahut!”³⁰

Dijetarët muslimanë i kanë përmbledhur thëniet dhe porositë profetike në lidhje me cytjet dhe ngacmimet djallëzore të cilat bëjnë që njeriu të dyshojë në Zotin e tij, të cilat është mirë që të dihen nga të gjithë, veçanërisht nga të rinjtë, e ato porosi janë pesë:

1. Nëse dikujt i vjen një ngacmim i tillë, le të thotë: “Unë i kam besuar Allahut dhe të Dërguarit të Tij!”
2. Të thotë: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”
3. Pasi të ketë thënë ashtu, le të fryjë (të pështyjë lehtë) në drejtim të shpatullës së tij të majtë tri herë.
4. T’i kërkojë Allahut mbrojtje nga e keqja e djallit (shejtanit).
5. T’i japi fund atyre ngacmimeve, pasi kjo është e mundur. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), ka thënë: “...(le t’i japë fund cytjeve) në këtë mënyrë, ato cytje dhe ngacmime do largohen nga ai.”³¹

²⁹ Hadithin e transmeton El Harith El Esh’arij dhe mban numrin 2863.

³⁰ E transmeton imam Muslimi me numër 134.

³¹ Kjo shtojcë gjendet në “Musnedin” e imam Ahmedit me numër 26203.

Këto që sapo përmendëm ishin nëntë mënyrat e parandalimit të ideologjisë ateiste, ndërsa në vijim do të përmendim shkurtimisht, mënyrat e ballafaqimit dhe kundërshtimit të asaj ideologjie.

Njeriu i cili ka rënë pre e ideologjisë ateiste është njëri prej këtyre të dyve:

- I pari, është musliman në fenë dhe besimin e tij, mirëpo ka rënë pre e dyshimit. Ky e mban këtë në veten e tij e nuk i bën thirrje të tjerëve të dyshojnë si ai, si dhe nuk tallet me parimet e fesë dhe besimit. Në këtë rast, ky njeri duhet këshilluar me këshillë të mirë e të sinqertë, fetare dhe llogjike, ashtu që të ripërtërijë besimin e tij e t'i qartësojë idetë dhe mendimet e tij. Mirëpo këtë këshillë, duhet t'ia japë ai njeri i cili ka maturi dhe dituri të gjerë, sidomos në lidhje me këto çështje, e jo ta bëjë këtë një injorant i cili do t'i shtonte edhe më tepër errësirë territ të tij. Cilido që do ta këshillojë atë njeri, qoftë hoxhë apo thirrës fetar, duhet të ndjejë dhembshuri dhe mëshirë për atë njeri, të cilin djajtë e kanë mashtruar.

- I dyti, është inatçi dhe kokëfortë. Ai e propagandon ateizmin si të ishte vlerë dhe jo antivlerë. Ai përmend sipas tij argumente në mbrojtje të asaj ideologjie dhe e përçmon besimin dhe çdo gjë që ai përfaqëson. Këtij njeriu i duhet dhënë përgjigja që meriton e nuk është aspak e udhës që të heshtet ndaj veprimit të tij. Kjo që sapo përmendëm ishte në aspektin e përgjithshëm, ndërsa më konkretisht, do të përmendim disa parime bazë të cilat duhet të merren parasysh, e ato janë si më poshtë:

E para: Kritika e adresuar ateistëve në lidhje me dyshimet që ata hedhin, duhet të karakterizohet nga dy elementë thelbësorë: **Urtësia** dhe **Dobia**. Pra, çështjet të trajtohen me urtësi dhe në formën më të përshtatshme, duke pasur për qëllim gjithnjë

arritjen e dobisë dhe largimin e dëmit. Ky parim duhet peshuar me “peshore floriri”, pasi ai është tepër i rëndësishëm. Gjatë kritikës së ideologjisë ateiste, ndonjëherë mund të jetë prej urtësisë të mos e përmendësh fare dyshimin, por vetëm ta sqarosh çështjen sipas pikëpamjes fetare, dhe kaq. Ndonjëherë tjetër, mund të jetë prej urtësisë të mos e përmendësh personin i cili e ka hedhur atë dyshim, por të përmendësh vetëm sqarimin e nevojshëm rreth tij. E gjithë kjo bëhet duke synuar t’i bësh dobi audiencës, apo lexuesit, e jo t’ua shtosh edhe më tepër dyshimin apo ta thellosh edhe më shumë problemin. Të gjitha këto kanë nevojë për maturi e përvojë, duke vlerësuar nivelin intelektual të atyre të cilëve po ju drejtohesh.

E dyta: Kritika adresuar ideologjisë ateiste duhet të jetë e fortë dhe e mirëpërgatitur. Nëse nuk do të jetë e tillë; nëse kritika ndaj asaj ideologjie do të ishte e dobët dhe e cunguar, atëherë ajo nuk ka për të qenë aspak bindëse, e në këtë mënyrë, dëmi prej saj ka për të qenë më i madh se dobia. Dijetari i madh, Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!), ka thënë³²: “Cilido që debaton me ateistët apo bidatçinjtë (trilluesit në fe), mirëpo që nuk është i aftë t’u tregojë vendin atyre e t’i kundërshtojë ashtu siç duhet lajthitjet e tyre (pasi i mungon dituria dhe argumenti), atëherë ai nuk i ka dhënë Islamit hakun që i takon; nuk e ka kryer obligimin e tij karshi dijes dhe besimit, si dhe nuk ka arritur që me fjalën e tij, të triumfojë e drejta e të zbrapset e kota, të qetësohen zemrat e të shtohet besimi.”³³

E treta: Kundërpërgjigjja ndaj ateistëve, ashtu si kundërshtimi i çdo grupacioni tjetër i cili kundërshton besimin e saktë dhe

³² “Mexhmu’ul fetaua”, vëllimi: 20, faqja: 164-165.

³³ Duket sikur ai ka dashur të thotë: Nëse nuk je i aftë për këtë punë, më mirë lëre ta bëj dikush tjetër. (shënim i përkthyesit).

akiden e pastër, duhet të bëhet sipas parimeve dhe metodologjisë së ehli-sunetit. E theksoj këtë, pasi shumë prej atyre të cilët i janë kundërvënë ideologjisë ateiste, e kanë bërë duke iu përmbajtur parimeve filozofike apo sipas parimeve të shpikura e të trilluara. Kjo i bën ato të dobëta dhe joefikase në njërin krahë, por edhe të dëmshme për besimin e vetë muslimanëve në krahun tjetër.

E katërta: Nëse do ishte i nevojshëm diskutimi dhe debati me ateistët rreth ideologjisë së tyre, atëherë preferohet që ai debat të jetë në kuadrin individual dhe jo debat publik, në mënyrë që të shmanget mundësia e përhapjes së dyshimeve të tyre mes njerëzve, të cilët jo të gjithë e kanë pjekurinë e duhur intelektuale për t'i kundërshtuar ato.

E pesta: Është e rëndësishme që gjatë zhvillimit të debatit me ateistin jobesimtar, të jetë debatuesi musliman ai i cili e orienton debatin duke bërë pyetje dhe duke kërkuar prej tij përgjigje dhe sqarim. Nëpërmjet përvojës është vërtetuar se kjo medotë është më efikase për arritjen e qëllimit dhe përmbushjen e synimit.

E gjashta: Nuk është mirë të debatojë me ateistët askush tjetër, përveç atyre që kanë dituri të gjerë dhe njohuri të mjaftueshme në lidhje me temën; që i njohin mirë pasaktësitë dhe dobësitë e doktrinës së tyre dhe që janë të mirëpërgatitur sa i përket strategjisë së zhvillimit të debatit dhe pretendimeve dhe dyshimeve të tyre.

MBYLLJE

Në mbyllje të këtij libërthi, po përmbledh disa sugjerime të cilat dëshiroj t'i adresoj te institucionet përkatëse, qofshin ato institucione arsimore-edukative, apo institucione fetare, duke shpresuar se do të merren në konsideratë.

1. Mendoj se do të ishte e udhës që dikasteret arsimore të organizonin seminare, në të cilat të trajtohej ateizmi bashkëkohor, si dhe të përcaktohen mënyrat adekuate për t'ju kundërvënë asaj ideologjie, si dhe t'u jepen përgjigjet e duhura, të gjitha dyshimeve që ngrenë ateistët, duke ndjekur metodologjinë e saktë akademike dhe shkencore.

2. Të kryhen studime statistikore në terren, në mënyrë që të matet ndikimi i ateizmit në mesin e të rinjve muslimanë, si dhe të shprehen sugjerimet e ndryshme në lidhje me format dhe mënyrat e kundërshtimit të tij, pasi studime të kësaj natyre, janë pothuajse inekzistente në vendet islame.

3. U bëj thirrje studentëve të teologjisë, studentëve akademikë të lëndës së akides (mësim-besimit), studentëve të kulturës islame, si dhe të gjithë hoxhallarëve dhe thirrësve, që nëpërmjet studimeve akademike dhe argumenteve konkretë, t'i bëjnë ballë kësaj ideologjie shkatërrimtare (të fesë dhe besimit).

4. I bëj thirrje të gjithë përdoruesve të internetit dhe rrjeteve sociale në veçanti, qofshin ata hoxhallarë apo nxënës të dijës që ateistëve dhe dyshimeve që ata hedhin, t'u kundërpërgjigjen me çdo lloj forme të mençur e efikase, sa herë që të jetë e mundur.

5. Sektorët e lëndës së akides (mësim-besimit) në universitete,

gjatë hartimit të plan-programit mësimor, duhet të vendosin mësimet në lidhje me këtë temë delikate, në mënyrë që nxënësi të ketë njohuri të mjaftueshme e të jetë në gjendje të qëndrojë përballë ideologjisë ateiste, me dituri dhe argument. Une mendoj se deri tani, kësaj teme nuk i është kushtuar vëmendja e duhur dhe se ajo ka nevojë për më shumë vëmendje.

6. Propozoj gjithashtu, që brenda programit arsimor, apo edhe jashtë tij, të zhvillohen seanca studimore, ku të studiohet ndonjë libër i cili ta ketë trajtuar temën e ateizmit sipas metodologjisë së mirëfilltë akademiko-shkencore. I tillë mund të jetë libri me titull “Argumentet dhe faktet e pakundërshtueshme, të cilat rrëzojnë nga themeli parimet e mohuesve (jobesimtarëve)”, i cili ka për autor dijetarin dhe hoxhën e nderuar Abdurrahman bin Seadi (Allahu e mëshiroftë!).

Prej veçorive e këtij libri është se në të nuk janë përmendur dyshimet e tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë, por lexuesi, gjatë leximit të tij mbushet me bindje dhe besim, aq sa, me lejen e Allahut, fiton imunitet të plotë ndaj çdo dyshimi që ateistët mund të hedhin.

Në mbyllje, lus Allahun e Madhëruar, Zotin e gjithësisë, që zemrat tona të na i mbushi me dashurinë për Të dhe besimin tek Ai, ndërsa gjuhët tona me përmendjen e Tij dhe falënderim! E lusim Atë që të na japë sukses për dëgjueshmëri dhe respektim ndaj Tij, si dhe të na mbrojë nga çdo sprovë dhe devijim, qofshin ato qartazi të dukshme apo të fshehta.

Allahu i Madhëruar e di më së miri!

Paqja, mëshira dhe bekimet e pashtershme qofshin mbi të dërguarin e Tij, Muhamedin, si edhe mbi të gjithë shokët dhe pasuesit e tij!